

## **KODI I ETIKËS<sup>12</sup>**

### **PËR EKSPERTËT KONTABËL TË REGJISTRUAR**

#### **Parathënie**

#### **Detyrimi për Zbatimin e Kodit**

#### **Përkufizime**

#### **PJESA A – KËRKESA TË PËRGJITHËSHME**

##### **10. Hyrja**

- 10.1 Parimet Themelore
- 10.2 Përdorimi i Metodës që Bazohet në Kuadrin Konceptual për Zbatimin e Parimeve Themelore
- 10.3 Kërcënimet dhe Masat Mbrojtëse
- 10.4 Zgjidhja e Konfliktëve Etike

##### **11. Parimet Themelore**

- 11.1 Integriteti
- 11.2 Objektiviteti
- 11.3 Kompetenca Profesionale dhe Kujdesi i Duhur
- 11.4 Konfidencialiteti
- 11.5. Sjellja Profesionale

#### **PJESA B - KËRKESA ETIKE PËR EKSPERTËT KONTABËL TË REGJISTRUAR QË E USHTROJNË PROFESIONIN NË PRAKTIKË**

##### **20. Te Përgjithëshme**

- 20.1 Hyrje
- 20.2 Ushtrimi i Profesionit dhe Papajtueshmëritë
- 20.3 Kërcënimet dhe Masat Mbrojtëse

##### **21. Emërimi i Ekspertit Kontabël të Regjistruar**

- 21.1 Pranimi i Klientit
- 21.2 Pranimi i Angazhimit

---

<sup>1</sup> Ndryshuar me vendimin e Asamblese Nr. 76 date 30.06.2010 dhe miratuar nga BMP me vendimin nr.31 date 08.09.2010

<sup>2</sup> Miratuar nga BMP me vendimin nr.21 date 24.04.2012

- 21.3 Angazhimet e Përbashkëta
- 21.4 Ndryshimi i Emërimit
  
- 22. Konfliktet e Interesit**
  
- 23 Opinionet Dytësore**
  
- 24. Honoraret dhe Shpërblimet**
  
- 25. Reklamimi i Shërbimeve Profesionale**
  
- 26. Dhuratat dhe Mikëpritja**
  
- 27. Marrja në Ruajtje e Aktiveve të Klientit**
  
- 28 Objektiviteti – Të Gjitha Shërbimet**
  
- 29 Pavarësia**
  - 29.1 Angazhimet për Dhënien e Sigurisë
  - 29.2 Zbatimi i Metodës Konceptuale për Pavarësinë
  - 29.3 Angazhimet e Sigurisë që Bazohen në Pohime
  - 29.4 Angazhimet e Dhënies së Sigurisë që Raportohen Drejtpërdrejt
  - 29.5 Raportet me Përdorime të Kufizuara
  - 29.6 Ekzistenca e Disa Palëve Përgjegjëse
  - 29.7 Konsiderata të Tjera
  - 29.8 Periudha e Angazhimit
  
- 30 Hyrja në Fuqi**

## **Parathënie**

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) ka për mision të sigurojë mirëushtrimin e profesionit, mbrojtjen e nderit dhe të pavarësisë të ekspertëve kontabël të regjistruar anëtarë të tij, si edhe të garantojë mbikëqyrjen e formimit të tyre profesional. Për këtë qëllim IEKA, nën autoritetin e saj dhe e udhëhequr nga praktikat më të mira profesionale e të etikës të nxjerra nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC), e veçanërisht bazuar në Kodin e Etikës për Profesionistët kontabël të IFAC-ut, harton këtë Kod të etikës i cili është i detyrueshëm për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët e tij gjatë dhënies së shërbimeve profesionale.

Një shenjë që e dallon profesionin kontabël në mbarë botën është pranimi i përgjegjësisë për të vepruar në interes të publikut. Profesionisti kontabël, e në mënyrë të veçantë, eksperti kontabël i regjistruar (audituesi), nuk ka përgjegjësinë që të kënaqë në mënyrë specifike vetëm nevojat e klientit ose të punëdhënësit të tij, ai duhet të veprojë në interes të publikut, dhe për këtë qëllim, duhet të njohë, të studiojë dhe të respektojë kërkesat e këtij Kodi.

Anëtarët e IEKA-s kanë një rol dhe një pozitë të rëndësishme në shoqëri. Ata do të mund ta mbajnë këtë pozitë, vetëm në se veprojnë në pajtim me rregullat e profesionit dhe demonstrojnë se shërbimet e tyre janë cilësore dhe në pajtim me standardet profesionale e etike.

Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar, me publikimin e Kodit të Etikës, përcakton kërkesat etike që duhet të zbatohen nga të gjithë profesionistët kontabël, anëtarë të tij.

## **Detyrimi për Zbatimin e Kodit**

Zbatimi i kërkesave të parashikuara në këtë Kod është i detyrueshëm për të gjithë anëtarët e Institutit, të cilët duhet të jenë në gjendje që të demonstrojnë në çdo kohë se veprimet dhe sjelljet e tyre janë në pajtim me Kodin.

Respektimi i kërkesave të Kodit sigurohet **në radhë të parë**, në pranimin e përgjegjësive të anëtarëve për të vepruar në mënyrë etike dhe në përmbushjen prej tyre të përgjegjësive në mënyrë vullnetare; **në radhë të dytë**, në detyrimin që imponon opinioni publik dhe kolegët në profesion, dhe **së fundi**, nga detyrimi për të respektuar kërkesat e Ligjeve e rregulloreve të organizimit dhe funksionimit të profesionit të ekspertëve kontabël të regjistruar, dhe të akteve tjera të nxjerra nga IEKA. Mosrespektimi i kërkesave të parashikuara në këtë Kod të etikës mund ta ekspozojë një anëtar të institutit përpara investimeve e procedimeve disiplinore.

Anëtarët e Institutit duhet të veprojnë në pajtim me frymën e Kodit, dhe nuk duhet të mjaftohen thjesht e vetëm me zbatimin të kushteve të përcaktuara në këtë Kod. Fakti

që një sjellje e caktuar nuk përmendet në Kod nuk përbën pengesë që eksperti kontabël i regjistruar të vlerësohet e të gjykohet në rastet kur ai bën një shkelje etike.

### **Përkufizime**

Në këtë Kod të Etikës për ekspertët kontabël të regjistruar, fjalët dhe frazat e mëposhtëme kanë këto kuptime:

**Angazhim për auditimin e pasqyrave financiare** – Një angazhim i dhënies së sigurisë, në të cilin një ekspert kontabël i regjistruar shpreh një opinion në se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, sipas një kuadri të zbatueshëm të raportimit financiar, siç mund të jetë për shembull, një angazhim që kryhet sipas Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Këtu përfshihet një auditim ligjor, i cili është auditim i pasqyrave financiare që kërkohet nga ligji apo nga akte të tjera rregullatore.

**Angazhim për dhënien e sigurisë** – Një angazhim, në të cilin një ekspert kontabël i regjistruar shpreh një konkluzion, që synon të përmirësojë nivelin e besimit për të gjithë përdoruesit e synuar, përveç palës që është përgjegjëse për rezultatet e vlerësimit apo të matjes të çështjes në fjalë sipas një kriteri të dhënë.

**Angazhim rishikimi për kontrollin e cilësisë** – Një proces që ka për qëllim të bëjë një vlerësim objektiv, përpara se të lëshohet raporti, lidhur me gjykimet e rëndësishme që ka bërë grupi i angazhimit dhe për konkluzionet që ka arritur në lidhje me formulimin e raportit.

**Drejtor ose zyrtar** – Personi i ngarkuar me administrimin dhe qeverisjen e një entiteti.

**Ekspert kontabël i regjistruar (auditues)** – Një profesionist kontabël, pavarësisht llojit të angazhimit që kryen (për shembull, auditim, shërbime tatimore apo konsulencë) person fizik, ose i punësuar apo i angazhuar në një firmë auditimi që jep shërbime profesionale. Ky term përdoret gjithashtu, për t'iu referuar një firme të ekspertëve kontabël të regjistruar, që ushtron profesionin në praktikë.

**Eksperti kontabël ekzistues** – Një ekspert kontabël i regjistruar, që aktualisht është emëruar për të kryer shërbime profesionale të auditimit, tatimore, të konsulencës ose shërbime të tjera të ngjashme për një klient.

**Entitet i Lidhur** - Një entitet që me klientin ka njërën nga marrëdhëniet e mëposhtëme:

- (a) entiteti ka kontroll direkt apo të tërthortë mbi klientin, kur ky i fundit është i rëndësishëm për këtë entitet;
- (b) entiteti ka interes të drejtpërdrejtë financiar tek klienti, kur entiteti ka influencë të konsiderueshme mbi klientin dhe interesi tek klienti është i rëndësishëm për të;
- (c) Një entitet, tek i cili klienti ka kontroll direkt ose të tërthortë;

(d) Një entitet, tek i cili klienti, ose një entitet që është i lidhur me klientin sipas pikës (c) ka një interes financiar të drejtpërdrejtë, i cili i jep atij influencë të konsiderueshme mbi entitetin dhe interesi është i rëndësishëm si për klientin ashtu edhe për entitetin e tij të lidhur sipas pikës (c); dhe

(e) Një entitet, i cili është nën një kontroll të përbashkët me klientin (“një entitet motër”) po qe se entiteti motër dhe klienti janë që të dy të rëndësishëm për entitetin që kontrollon si klientin ashtu edhe entitetin motër.

**Entitet i listuar** – Një entitet, aksionet/pjesët e kapitalit apo detyrimet e të cilit janë të kuotuar / të listuara në bursë ose në një organizëm tjetër të ngjashëm.

**Familjar i drejtpërdrejtë** – Bashkëshorti (ose ekuivalenti i tij) apo një person në ngarkim.

**Familjar i ngushtë** – Një prind, fëmijë, motër, vëlla, që nuk është anëtar i drejtpërdrejtë i familjes.

**Firmë** - (a) Një ekspert kontabël i regjistruar person fizik, një ortakëri ose shoqëri e ekspertëve kontabël të regjistruar;

**Firmë Rrjet** – Një entitet nën kontroll, pronësi ose menaxhim të përbashkët me firmën, apo një entitet, për të cilin një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, që ka njohuri për të gjithë informacionet përkatëse, në mënyrë të arsyeshme do të arrinte në konkluzionin se kemi të bëjmë me pjesë të një firme kombëtare apo ndërkombëtare.

**Grupi i angazhimit** - I gjithë personeli që merr pjesë në kryerjen e një angazhimi, përfshirë edhe ekspertët e tjerë që kontraktohen nga eksperti kontabël i regjistruar, për këtë qëllim.

**Grupi i dhënies së sigurisë** - (a) Të gjithë anëtarët e një grupi që angazhohen për dhënien e sigurisë:

(b) Të gjithë personat e tjerë brenda një firme auditimi, të cilët mund të influencojnë direkt në rezultatin e angazhimit për dhënien së sigurisë.

(c) Në rastin e një klienti që i auditohen pasqyrat financiare, të gjithë pjestarët e personelit brenda një firme rrjet, të cilët mund të influencojnë direkt rezultatin e angazhimit të auditimit të pasqyrave financiare.

**Honorar i kushtëzuar** - Një honorar (kuotë pagesë) i llogaritur mbi baza të paracaktuara, që lidhen me përfundimin/rezultatin e një transaksioni apo rezultatin e punës që do të kryhet. Një honorar që caktohet nga gjykata apo nga një autoritet tjetër publik nuk është honorar i kushtëzuar.

**Interes Financiar** - Një pjesëmarrje (interes) në kapital apo në instrumentet e tjera të letrave me vlerë, obligacioneve, huave apo detyrimeve të tjera të një entiteti, përfshirë të drejtat dhe detyrimet, e cila ka për qëllim marrjen e interesave dhe të derivativave të tyre të lidhura direkt me këto pjesëmarrje.

**Interes financiar i drejtpërdrejtë** – Një interes financiar:

- që zotërohet drejtpërdrejt apo është nën kontrollin e një individi ose të një entiteti të caktuar (përfshirë interesat që menaxhohen lirshëm nga të tjerët); ose
- i dobishëm, që zotërohet përmes një investimi kolektiv në një aktiv, pasuri të patundëshme, trust apo ndërmjetës të tjerë, mbi të cilët individi apo entiteti ka kontroll.

**Interes financiar i tërthortë** – Një interes financiar i dobishëm, që zotërohet përmes një investimi të përbashkët në një aktiv, pasuri të paluajtshme, trust apo ndërmjetës të tjerë, mbi të cilat individi ose entiteti nuk ka kontroll.

**Klient i auditimit (të cilit i auditohen pasqyrat financiare)** - Një entitet, tek i cili një firmë kryen një angazhim për auditimin e pasqyrave financiare. Kur klienti është një shoqëri e listuar në bursë, në klientin që i auditohen pasqyrat financiare, gjithmonë përfshihen edhe entitetet e tij të lidhura.

**Klienti i sigurisë (klienti të cilit i jepet shërbimi i sigurisë)** - Pala përgjegjëse është personi (personat), i cili (të cilët):

- (a) në një angazhim që bazohet në raportimin e drejtpërdrejtë, ka përgjegjësinë për çështjen në fjalë (që shqyrtohet).
- (b) në një angazhim që bazohet në pohim, ka përgjegjësinë për informacionet që kanë të bëjnë me çështjen në fjalë (që shqyrtohet) dhe mund të ketë përgjegjësinë edhe për vetë çështjen.

(Për një klient, të cilit i jepet shërbimi i sigurisë, i cili është një klient që i auditohen pasqyrat financiare, shiko përkufizimin që jepet për klientin që i auditohen pasqyrat financiare.)

**Krejt i/e parëndësishëm** - Një çështje që mendohet të jetë e vogël dhe e parëndësishme.

**Ortak angazhimi** – Eksperti kontabël i regjistruar, anëtar i një firme auditimi, që është përgjegjës për angazhimin dhe raportin që lëshohet në emër të firmës, të cilit i është dhënë autoriteti i duhur nga një organizëm profesional, ligjor apo rregullator dhe i njohur nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar.

**Pasqyrat Financiare** – Bilancet, pasqyrat e rezultatit apo llogaritë e humbje fitimeve, pasqyrat e ndryshimeve në gjendjen financiare (që mund të paraqiten në një shumëllojshmëri mënyrash, për shembull, si një pasqyrë e flukseve të parasë ose si një pasqyrë e rrjedhjeve të fondeve), shënimet anekse dhe pasqyra e dokumente të tjera shpjeguese, që identifikohen si pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

**Pavarësia:**

(a) **në të menduar** – gjendje të menduari që lejon dhënien e një opinioni pa u ndikuar nga influencat që kompromentojnë gjykimin profesional, e cila e lejon një individ të veprojë me integritet dhe të ushtrojë objektivitetin e gjykimin profesional.

(b) **në dukje** – mënjanim i atyre fakteve dhe rrethanave që janë kaq të rëndësishme, sa që një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, që ka njohuri për të gjitha informacionet përkatëse, përfshirë masat mbrojtëse që zbatohen, do të arrijë në mënyrë të arsyeshme në përfundimin se kemi të bëjmë me kompromentimin e integritetit, objektivitetit ose të skepticizmit profesional të një firme apo të një anëtari të grupit të angazhimit.

**Reklamimi** - Komunikimi për publikun i informacioneve që lidhen me shërbimet apo aftësitë profesionale të një eksperti kontabël të regjistruar, që e ushtron profesionin në praktikë në mënyrë të pavarur, sipas këndvështrimit të prokurimit të biznesit profesional.

**Shërbime profesionale** – Shërbimet që kërkojnë aftësi në fushën e kontabilitetit dhe fusha të tjera të lidhura, të cilat kryhen nga një ekspert kontabël i regjistruar, ku përfshihen shërbimet e auditimit, të tatimeve, të konsulencës financiare, kontabël e menaxheriale dhe ato të menaxhimit financiar.

**Zyrë** – Një nëngrup i dallueshëm qoftë i organizuar sipas linjës gjeografike ose sipas praktikës së shërbimeve.

## **PJESA A – KËRKESA TË PËRGJITHËSHME**

### **10. Hyrja**

#### **10.1 Parimet Themelore**

10.1.1 Ekspertët kontabël të Regjistruar, anëtarë të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA), janë të detyruar të veprojnë në pajtim me parimet themelore që jepen në vijim:

(a) *Integriteti*

Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të jetë i drejtpërdrejtë dhe i ndershëm në të gjitha marrëdhëniet e tij profesionale

(b) *Objektiviteti*

Një ekspert kontabël i regjistruar nuk lejohet të paragjykojë, të ketë konflikt interesash, ose të influencohet nga të tjerët me qëllim mënjanimin e gjykimit profesional.

(c) *Kompetenca Profesionale dhe Kujdesi i Duhur*

Një ekspert kontabël i regjistruar ka detyrimin që vazhdimisht të zotërojë njohuri dhe aftësi profesionale në atë nivel në të cilin ai garanton se klientët e tij do të marrin shërbime profesionale kompetente, të cilat bazohen në zhvillimet aktuale të praktikës, të legjislacionit dhe të teknikave përkatëse. Në kryerjen e shërbimeve profesionale, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të veprojë me kujdes dhe në pajtim me standardet profesionale e teknike.

(d) *Konfidencialiteti*

Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të respektojë konfidencialitetin për informacionet që ai merr si rrjedhojë e veprimtarive profesionale; ai nuk duhet t'ua tregojë këto informacione palëve të treta pa patur autorizimin e duhur dhe specifik, **përveç rasteve** kur, për dhënien e këtyre informacioneve ekziston e drejta apo detyrimi profesional. Informacioni konfidencial që merret si rrjedhojë e veprimtarive që kryhen në kuadër të ushtrimit të profesionit, apo në kuadrin e punësimit pranë një eksperti tjetër, apo një firme, nuk duhet të përdoret për avantazhe profesionale për të apo për palët e treta.

(e) *Sjellja Profesionale*

Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të respektojë ligjet dhe rregullat e vendosura dhe të mënjanojë çdo veprim që diskrediton profesionin.



## **10.2 Përdorimi i Metodës që Bazohet në Kuadrin Konceptual për Zbatimin e Parimeve Themelore**

- 10.2.1 Rrethanat, në të cilat punojnë ekspertët kontabël të regjistruar mund të bëjnë që të kërcënohet respektimi i parimeve themelore. Është e pamundur të përkufizohet çdo situatë që krijon kërcënime, dhe të specifikohet veprimi i duhur që çon në zvogëlimin e efekteve të kërcënimeve. Veç kësaj, mund të ndryshojnë qoftë natyra e angazhimeve ashtu edhe punët që duhen kryer, dhe për pasojë, për kërcënimet (rreziqet) e ndryshme që mund të krijohen, do të duhet të zbatohen masa mbrojtëse të ndryshme. Prandaj, publiku është i interesuar që të zbatohet një kuadër konceptual, i cili kërkon që një ekspert kontabël i regjistruar të identifikojë, vlerësojë dhe të trajtojë kërcënimet që i bëhen respektimit të parimeve themelore, dhe jo që ai thjesht të respektojë një paketë të rregullave specifike, të cilat mund të ndodhë që të jenë edhe arbitrare. Ky Kod jep një kuadër bazë që ndihmon ekspertët kontabël të regjistruar për të identifikuar, vlerësuar dhe reaguar ndaj kërcënimeve që i bëhen respektimit të parimeve themelore. Në qoftë se kërcënimet e identifikuar nuk janë të krejt të parëndësishme, një ekspert kontabël i regjistruar duhet që, atje ku kjo është e përshtatëshme, të zbatojë ato masa mbrojtëse, të cilat eliminojnë kërcënimet ose i zvogëlojnë ato në një nivel të ulët, të atillë që nuk kompromenton respektimin e parimeve themelore.
- 10.2.3 Një ekspert kontabël i regjistruar është i detyruar të vlerësojë çdo kërcënim që i bëhet respektimit të parimeve themelore, kur ai ka dijeni për këto kërcënime ose, kur në mënyrë të arsyeshme, mund të parashikohet se ai ka njohuri për rrethanat apo marrëdhëniet që mund të kompromentojnë respektimin e parimeve themelore.
- 10.2.4 Për vlerësimin e rëndësisë së një kërcënimi, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të mbajë parasysh si faktorët cilësorë ashtu edhe ata sasiorë. Në qoftë se një ekspert kontabël i regjistruar nuk ka mundësi të zbatojë masat e duhura mbrojtëse, ai duhet të refuzojë ose të mos vazhdojë kryerjen e shërbimit profesional në të cilën është përfshirë, ose kur shihet e nevojshme, të japë dorëheqjen nga klienti.
- 10.2.5 Një ekspert kontabël i regjistruar mund të shkelë ndonjë dispozitë të këtij Kodi në mënyrë të paqëllimshme. Kjo shkelje, në varësi nga natyra dhe rëndësia e çështjes, mund të mos kompromentojë respektimin e parimeve themelore, po qe se ajo korrigjohet menjëherë pas zbulimit të saj dhe, po qe se menjëherë zbatohen edhe masat e duhura mbrojtëse.
- 10.2.6 Pjesa B e këtij Kodi jep disa shembuj, të cilët kanë për qëllim të ilustrojnë mënyrën e zbatimit të kuadrit konceptual. Këta shembuj **as kanë për qëllim, dhe as duhet të interpretohen si një listë gjithëpërfshirëse që përmban të gjithë rrethanat, me të cilat ndeshet një ekspert kontabël i regjistruar, të cilat mund të krijojnë kërcënime për respektimin e parimeve themelore.** Për pasojë, për një ekspert kontabël të regjistruar nuk është e mjaftueshme që

ai thjesht të respektojë shembujt e paraqitur, pasi kuadri duhet të zbatohet sipas rrethanave të veçanta.

### **10.3 Kërcënimet dhe Masat Mbrojtëse**

10.3.1 Respektimi i parimeve themelore, potencialisht mund të kërcënohet nga një shumëllojshmëri rrethanash. Kërcënimet kategorizohen në:

- (a) **Kërcënimet e egoizmit (të interesit vetiak)**, të cilat mund të ndodhin si rrjedhojë e interesave financiare ose të interesave të tjera që ka një ekspert kontabël i regjistruar ose një anëtar i drejtpërdrejtë apo i ngushtë i të familjes së tij.
- (b) **Kërcënimet e vetë rishikimit**, të cilat mund të ndodhin në rastet kur një gjykim i dhënë duhet të rivlerësohet apo përdoret po nga vetë eksperti kontabël i regjistruar që është përgjegjës për dhënien e këtij gjykimi.
- (c) **Kërcënimet e favorizimit (përkrahjes)**, të cilat mund të ndodhin kur një ekspert kontabël i regjistruar favorizon një qëndrim apo një opinion deri në atë pikë, sa që kompromentohet objektiviteti i mëvonshëm;
- (d) **Kërcënimet e familiaritetit**, të cilat mund të ndodhin, në rastet kur për shkak të një marrëdhënie të afërt, një ekspert kontabël i regjistruar bëhet shumë dashamirës (tregon shumë simpati) ndaj interesave të të tjerëve; dhe
- (e) **Kërcënimet e frikësimit**, të cilat mund të ndodhin kur një ekspert kontabël i regjistruar, në kryerjen e një veprimi me objektivitet, mund të frenohet prej rreziqeve aktuale ose të atyre marra me mend.

Pjesa B e Kodit jep shembuj të rrethanave që, për ekspertët kontabël të regjistruar, mund të krijojnë kategoritë e mësipërme të kërcënimeve.

10.3.2 Masat mbrojtëse që mund të eliminojnë ose zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm ndahen në dy kategori të mëdha:

- (a) Masat mbrojtëse që krijohen nga profesioni, legjislacioni ose nga rregullat; dhe
- (b) Masat mbrojtëse të mjedisit të punës.

10.3.3 Disa masa mbrojtëse mund të rritin mundësinë e identifikimit ose të frenimit të sjelljes jo-etike. Këto masa mbrojtëse, të cilat mund të krijohen nga profesioni, legjislacioni, apo rregullat, përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në to:

- Sistemet e ankesave që përdor profesioni ose organizmi rregullator, të cilat u japin mundësi kolegëve, punëdhënësve dhe publikut që të tërheqin

vëmendjen ndaj sjelljeve jo-profesionale ose jo-etike të ekspertëve kontabël të regjistruar.

- Detyrimin që kanë ekspertët kontabël të regjistruar për të raportuar për shkeljet e kërkesave etike.

10.3.4 Natyra e masave mbrojtëse që zbatohen ndryshon sipas rrethanave. Kur ushtron gjykimin profesional, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të mbajë parasysh atë ç`ka do të konkludonte si të papranueshme një palë e tretë e arsyeshme, e cila ka njohuri qoftë për informacionet, ashtu edhe për rëndësinë e kërcënimeve dhe të masave mbrojtëse që zbatohen.

#### **10.4 Zgjidhja e Konflikteve Etike**

10.4.1 Gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë me parimet themelore, një ekspert kontabël i regjistruar mund të kërkohet të zgjidhë një konflikt që lidhet me zbatimin e këtyre parimeve.

10.4.2 Kur eksperti kontabël inicon një proces formal ose jo formal të zgjidhjes së konfliktit, ai duhet të marrë në konsideratë, si pjesë përbërëse të procesit të zgjidhjes, qoftë individualisht ose edhe së bashku, faktorët e mëposhtëm:

- (a) Faktet përkatëse;
- (b) Çështjet etike që lidhen me faktet;
- (c) Parimet themelore që lidhen me çështjen në fjalë;
- (d) Proçedurat e brendëshme të vendosura nga profesioni; dhe
- (e) Mënyrat alternative të veprimit.

Nëpërmjet këtij vlerësimi eksperti kontabël i regjistruar përcakton drejtimin e duhur të veprimit që është në koherenë me parimet themelore. Ai duhet, gjithashtu, të peshojë pasojat e çdo veprimi tjetër të mundshëm. Në qoftë se çështja mbetet e pazgjidhur, për zgjidhjen e saj, eksperti kontabël duhet të konsultohet me persona të tjerë të duhur, brenda firmës së auditimit.

10.4.3 Në rastet kur bëhet fjalë për një konflikt me palët e treta, ose një konflikt brenda një organizate/klienti, një ekspert kontabël i regjistruar duhet, gjithashtu, të shikojë mundësinë e konsultimit me personat që janë të ngarkuar me qeverisjen e organizatës, siç janë bordi i drejtorëve ose komiteti i auditimit.

10.4.4 Është në interes të ekspertit kontabël që ai të dokumentojë thelbin e çështjes dhe detajet e diskutimeve të bëra ose të vendimeve të marra, të cilat kanë të bëjnë me çështjen në fjalë.

- 10.4.4 Në qoftë se një konflikt i konsiderueshëm nuk mund të zgjidhet, një ekspert kontabël i regjistruar mund të marrë këshilla profesionale për trajtimin e çështjeve etike, pa shkelur konfidencialitetin, nga organizmi profesional apo edhe nga këshilltarët ligjorë. Për shembull, një ekspert kontabël i regjistruar mund të ketë hasur një mashtrim, raportimi i të cilit mund të çojë në shkeljen e përgjegjësisë së tij, lidhur me konfidencialitetin. Në këtë rast, ai duhet të vlerësojë marrjen e këshillave ligjore për të përcaktuar në se ka ose jo ndonjë detyrim për të raportuar.
- 10.4.5 Në qoftë se, edhe pasi janë përdorur të gjitha mundësitë përkatëse, konflikti etik mbetet përsëri i pazgjidhur, një ekspert kontabël i regjistruar duhet, kur është e mundur, të refuzojë vazhdimin e lidhjes me çështjen që ka krijuar konfliktin. Sipas rrethanave, eksperti kontabël i regjistruar mund të vendosë të tërhiqet nga grupi i angazhimit, nga detyra specifike, apo edhe të japë dorëheqjen krejtësisht nga angazhimi, ose nga firma ku është punësuar.
- 10.4.6 Anëtar i institutit duhet të përpiqet të shmangë mosmarrëveshjet me kolegët, por në se ato ndodhin ai duhet të bëjë përpjekje për t'i zgjidhur me pajtim. Kur mosmarrëveshja mbetet e pazgjidhur ai mund të vërë në dijeni presidentin e IEKA-s, i cili luan rolin e arbitrit për një rregullim të mundshëm pajtues.

## **11. Parimet Themelore**

### **11.1 Integriteti**

- 11.1.1 Parimi i integritetit imponon detyrimin për të gjithë ekspertët kontabël të regjistruar, që në marrëdhëniet e tyre profesionale dhe të biznesit të jenë të drejtpërdrejtë dhe të ndershëm. Integriteti përfshin, gjithashtu, sjelljen e drejtë dhe sinqeritetin.
- 11.1.2 Një ekspert kontabël i regjistruar nuk duhet të ketë lidhje me raportet, komunikimet apo me informacione të tjera, kur krijohet bindja se ky informacion:
- (a) Përmban një deklaram fals ose një deklaram që keqduhëzon;
  - (b) Përmban pasqyra ose informacione që janë marrë në mënyrë të nxituar; ose
  - (c) Lë jashtë apo fsheh informacionin e kërkuar që duhej të ishte i përfshirë, kur kjo lënie jashtë ose fshehje është keqduhëzuese (çorientuese).
- 11.1.3 Nuk mund të konsiderohet se një ekspert kontabël i regjistruar ka shkelur paragrafin e mësipërm, në qoftë se në lidhje me njërin nga çështjet që përmban ky paragraf, ai paraqet një raport të modifikuar.

## **11.2 Objektiviteti**

- 11.2.1 Parimi i objektivitetit imponon detyrimin për të gjithë ekspertët kontabël të regjistruar që ata të mos kompromentojnë gjykimin e tyre profesional ose të biznesit për shkak të paragjyimit, konfliktit të interesave ose të influencës së tepruar të të tjerëve.
- 11.2.2 Një ekspert kontabël i regjistruar mund të vihet përballë situatave që dëmtojnë objektivitetin. Megjithëse është praktikisht e pamundur të përkufizohen apo edhe të përshkruhen të gjitha këto situata, ajo që duhet bërë është shmangia e atyre marrëdhënieve që paragjykojnë ose influencojnë tepër në gjykimin profesional të ekspertit kontabël.

## **11.3 Kompetenca Profesionale dhe Kujdesi i Duhur**

- 11.3.1 Parimi i kompetencës profesionale dhe i kujdesit të duhur imponon mbi ekspertët kontabël të regjistruar detyrimet e mëposhtëme:
- (a) Të zotërojnë njohuri dhe aftësi profesionale në nivelin që kërkohet për të garantuar që klientët e tyre marrin shërbime profesionale kompetente; dhe
  - (b) Kur japin shërbime profesionale ata duhet të veprojnë me kujdes dhe në pajtim me standardet teknike e profesionale të zbatueshme.
- 11.3.2 Shërbimi profesional kompetent kërkon që gjatë zbatimit të njohurive dhe aftësive profesionale të nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi, të ushtrohet një gjykim i shëndoshë. Kompetenca profesionale mund të ndahet në dy faza të veçanta:
- (a) Arritja e kompetencës profesionale; dhe
  - (b) Mbajtja e kompetencës profesionale.
- 11.3.3 Mbajtja e kompetencës profesionale kërkon marrjen e vazhdueshme të njohurive dhe njohjen e zhvillimeve tekniko-profesionale dhe të biznesit. Ekspertët kontabël të regjistruar janë të detyruar që çdo vit të marrin pjesë në seminarët e kualifikimit të vijueshëm profesional, të cilat shërbejnë për të zhvilluar më tej dhe mbajtur aftësitë profesionale që nevojiten për të dhënë shërbime profesionale kompetente.
- 11.3.4 Kujdesi përfshin përgjegjësinë për të vepruar në pajtim me kërkesat e një detyre të caktuar, me vëmendje, plotësisht dhe në afatet e duhura kohore.
- 11.3.5 Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të ndërmarrë ato hapa që japin garanci, se personat të cilët punojnë nën autoritetin e tij, në një kapacitet të caktuar profesional, janë të trainuar dhe mbikëqyren në mënyrën e duhur.

11.3.6 Kur është e nevojshme, një ekspert kontabël i regjistruar duhet t'i ndërgjegjësojë klientët dhe përdoruesit e tjerë të shërbimeve profesionale, për kufizimet e vetvetishme të këtyre shërbimeve, me qëllim që ata të mos e interpretojnë opinionin e dhënë prej tyre si një pohim të faktit.

#### **11.4 Konfidencialiteti**

11.4.1 Parimi i konfidencialitetit imponon për ekspertët kontabël të regjistruar detyrimin që ata të shmangin:

- (a) Nxjerrjen jashtë firmës së auditimit të informacioneve konfidenciale të marra si rrjedhojë e një marrëdhënie profesionale ose të biznesit, pa marrë më parë një autorizim të përshtatshëm dhe specifik, ose përveç rasteve kur ekziston një detyrim apo e drejtë ligjore a profesionale për dhënien e këtyre informacioneve; dhe
- (b) Përdorimin e informacioneve konfidenciale, të marra si rrjedhojë e një marrëdhënie profesionale ose të biznesit, për avantazhin e tyre personal apo edhe avantazhin e palëve të treta.

11.4.2 Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të ruajë konfidencialitetin madje edhe në mjedisin social. Eksperti kontabël duhet të jetë vigjilent ndaj mundësisë së dhënies së informacioneve konfidenciale në mënyrë të paqëllimshme, veçanërisht në rrethanat, kur ai është i lidhur për një kohë të gjatë me një ortak të biznesit ose me një anëtar të afërt apo të drejtpërdrejtë të familjes së tij.

11.4.3 Një ekspert kontabël i regjistruar duhet gjithashtu, të mbajë konfidencialitetin edhe për informacionet e marra nga një klient perspektiv.

11.4.4 Një ekspert kontabël i regjistruar duhet, gjithashtu, të vlerësojë nevojën e mbajtjes së konfidencialitetit edhe brenda firmës së auditimit.

11.4.5 Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme për t'u siguruar që personeli që është nën kontrollin e tij, dhe personat prej të cilëve janë marrë këshilla e ndihmë, respektojnë detyrimin që ka eksperti kontabël për të mbajtur konfidencialitetin.

11.4.6 Nevoja e respektimit të parimit të konfidencialitetit vazhdon edhe pasi eksperti kontabël i regjistruar përfundon marrëdhëniet me klientin e tij. Megjithëse kur merr një klient të ri, një ekspert kontabël i regjistruar ka të drejtë të përdorë eksperiencën e mëparëshme, ai nuk duhet të përdorë, të paraqesë ose të japë ndonjë informacion me karakter konfidencial të mësuar apo edhe të marrë si rrjedhojë e një marrëdhënieje profesionale ose të biznesit.

11.4.7 Më poshtë jepen rrethanat kur ekspertët kontabël të regjistruar kërkohet apo mund të kërkohet të japin informacione konfidenciale, ose kur dhënia e këtyre informacioneve mund të jetë e përshtatëshme:

- (a) Dhënia e informacioneve lejohet nga ligji dhe autorizohet nga klienti;
- (b) Dhënia e informacioneve kërkohet nga ligji, për shembull:
  - (i) Prodhimi i dokumenteve ose paraqitjet e evidencave, gjatë procedurave ligjore, apo
  - (ii) Zbulimi përpara prokurorit të Republikës i fakteve që përbëjnë krim, për të cilat eksperti kontabël i regjistruar merr dijëni gjatë ushtrimit të funksionit të tij; dhe
  - (iii) Informimi i autoriteteve përkatëse rregullatore publike, për informacionet që nxjerrin në dritë shkeljet e ligjit; dhe kur
- (c) Ekziston një detyrim ose një e drejtë profesionale për dhënien e informacioneve, kur një gjë e tillë nuk ndalohet nga ligji:
  - (i) Kur zbatohen procedurat e kontrollit të cilësisë të vendosura nga organizmi profesional, ose nga autoritete të tjera të ngarkuara për këtë qëllim;
  - (ii) Për t'iu përgjigjur një kërkesë ose një investigimi të bërë nga organizmi profesional ose një organizëm tjetër rregullator;
  - (iii) Kur mbrohen interesat profesionale të një eksperti kontabël në një seancë ligjore; ose
  - (iv) Për të respektuar standardet teknike dhe kërkesat etike.

11.4.8 Për të përcaktuar nëse duhet të japin ose jo një informacion konfidencial, ekspertët kontabël duhet të mbajnë parasysh çështjet e mëposhtëme:

- (a) Faktin në se, nga dhënia e pëlqimit prej klientit për ekspertin kontabël të regjistruar që ai të japë informacione, do të mund të dëmtoheshin interesat e të gjithë palëve, përfshirë edhe palët e treta, interesat e të cilave mund të ndikohen nga këto informacione;
- (b) Faktin në se informacionet përkatëse njihen ose janë të provuara, deri në atë masë që kjo është praktikisht e mundur. Për të përcaktuar llojin e informacioneve që do të jepen, nëse duhet që një gjë e tillë të bëhet, në rastet e fakteve të paprovuara, informacioneve jo të plota apo konkluzioneve të paprovuara, duhet të përdoret gjykimi profesional; dhe

- (c) Tipi i komunikimit që parashikohet dhe kujt i adresohet. Ekspertët kontabël të regjistruar duhet të jenë të bindur që palët, të cilave ju adresohet komunikimi, janë përfituesit e apo marrësit e duhur.

## **11.5. Sjellja Profesionale**

11.5.1 Parimi i sjelljes profesionale imponon detyrimin që ekspertët kontabël të regjistruar të respektojnë ligjet dhe rregullat dhe të mënjanojnë çdo veprim që mund të diskreditojë profesionin. Këtu përfshihen ato veprime, që një palë e tretë e informuar dhe e arsyeshme, e cila ka njohuri për të gjithë informacionet respektive, do t'i vlerësonte si veprime me ndikime negative ndaj reputacionit të mirë të profesionit.

11.5.2 Ekspertët kontabël të regjistruar ndalohen të bëjnë publicitet personal.



**PJESA B: KËRKESA ETIKE PËR EKSPERTËT KONTABËL TË REGJISTRUAR QË E USHTROJNË PROFESIONIN NË PRAKTIKË**

**20. Te Përgjithëshme**

**20.1 Hyrje**

20.1.1 Kjo Pjesë e Kodit ilustron mënyrën se si duhet të zbatohet nga ekspertët kontabël të regjistruar kuadri konceptual që jepet në Pjesën A. Shembujt që jepen në vijim as nuk parashikohet të jenë, e as duhet të interpretohen, si një listë ku të përfshihen të gjitha rrethanat, të cilat mund të krijojnë kërcënime ndaj respektimit të parimeve themelore, me të cilat ndeshet një ekspert kontabël i regjistruar. Për pasojë, për një ekspert kontabël të regjistruar, nuk mjafton që ai thjesht të veprojë sipas shembujve të paraqitur, pasi kuadri duhet të zbatohet sipas rrethanave të veçanta që paraqiten.

**20.2 Ushtrimi i Profesionit dhe Papajtueshmëritë**

20.2.1 Ekspertët kontabël të regjistruar, anëtarë të Institutit mund ta ushtrojnë profesionin e tyre: (i) në mënyrë të pavarur (individuale), (ii) të grupuar në firma auditimi, apo si të punësuar tek një ekspert tjetër i pavarur ose tek një shoqëri e ekspertëve kontabël të regjistruar.

20.2.2 Funkzionet e ekspertit kontabël të regjistruar janë të papajtueshme me çdo angazhim ose akt të natyrës që dëmton drejtëpërdrejt a tërthorazi pavarësinë dhe ndershmërinë e tij. Ushtrimi i funksionit të ekspertit kontabel të regjistruar është i papajtueshem me çdo post të punësuar, me përjashtim të punësimit tek një ekspert kontabel të regjistruar tjetër ose në një shoqëri auditimi të regjistruar në regjistrin publik të EKR-ve.

Ushtrimi i funksionit të ekspertit kontabel të regjistruar është i papajtueshem me ushtrimin në menyre të pavarur të cdo profesioni tjetër.

Ushtrimi i funksionit të EKR-se është i papajtueshem me cdo angazhim, me cdo akt tregtie a ndermjetesimi, me cdo mandat tregtar, perfaqesimi gjyqesor në çështjet që interesojnë klientët e tij, me çdo punë kontrolli në një entitet, në të cilin ai ka drejtëpërdrejt a tërthorazi interesa.

Ekspertit kontabël të regjistruar i lejohet ushtrimi i veprimtarisë së mësimdhënies me kohë të pjesshme dhe pjesmarrja në seminare, konferenca apo veprimtari të ngjashme me to.

20.2.2(a) Anëtarët e IEKAs nuk mund të kryejnë shërbimet e dhënis së sigurisë për ato kliente të cilëve ata vete, apo një nga antarët apo të punësuarit e firmës së tij, i kanë ofruar shërbimin e mbajtjes së kontabilitetit apo përgatitjes së pasqyrave financiare.

- 20.2.3 Një ekspert kontabël i regjistruar nuk duhet të angazhohet në ndonjë aktivitet, punë, apo çdo lloj veprimtarie tjetër, e cila dëmton apo mund të dëmtojë integritetin, objektivitetin, apo reputacionin e mirë të profesionit dhe që për rrjedhojë, do të ishte e papajtueshme me dhënien e shërbimeve profesionale.
- 20.2.3.(a) Per shkak të ruajtjes dhe forcimit të funksionit, imazhit, integritetit dhe interesave të institutit dhe anëtarëve, me qëllim mos-cenimin e interesave të IEKAs dhe anëtarëve të saj, anëtarësimi në organizata të tjera është subjekt i aprovimit nga strukturat perkatëse të Institutit dhe do jepet rast pas rasti në përputhje me kriteret që përcaktohen për këtë qëllim nga KD.
- 21.2.4 Kur një ekspert kontabël i regjistruar parashikon që të mbështetet në këshillën apo punën e një eksperti, ai duhet të vlerësojë në se kjo mbështetje është e justifikuar. Eksperti kontabël i regjistruar duhet të mbajë parasysh faktorë të tillë si reputacioni, ekspertiza, burimet e mundëshme dhe standardet profesionale e etike të zbatueshme. Ky informacion mund të merret nga lidhja e mëparëshme me ekspertin ose nga konsultimi që eksperti kontabël i regjistruar bën me të tjerët.
- 20.2.5 Anëtarët e institutit janë individualisht përgjegjës për aktet e tyre profesionale. Përgjegjësia e firmave të auditimit të njohura nga instituti nuk zëvendëson përgjegjësinë personale të çdo eksperti kontabël të regjistruar ndaj institutit, përgjegjësi që rrjedh nga kryerja e punimeve për llogari të firmave. Kjo përgjegjësi del nga nënshkrimi i tij personal, si dhe nga viza e nënshkrimi i firmës së auditimit.
- 20.2.6 Nje anëtar i institutit mund të përdorë në ushtrimin e profesionit deri në pesë punonjës të punësuar, të caktuar për kontrollin ligjor të llogarive, të cilët i deklaron në Institut. Në këtë numër nuk përfshihen stazhierët dhe të punësuarit për punë jo-profesionale. Në rastin e shoqërive të ekspertëve kontabël të regjistruar, numri i të punësuarve për punë profesionale është në varësi të numrit të ekspertëve kontabël të regjistruar, ortakë të shoqërisë, sipas kufijve të treguara më sipër.
- 20.2.7 Eksperti kontabël i regjistruar, anëtar i institutit duhet të krijojë për çdo angazhim të auditimit një dosje të plotë që përmban identitetin e klientit, të drejtuesve të tij, si dhe të gjithë dokumentacionin e evidencën e marrë ose të përgatitur prej tij gjatë kryerjes së auditimit. Ai është i detyruar gjithashtu, që për çdo klient të mbajë regjistër profesional, ku shënon punimet e ndryshme të kryera nga ai vetë ose nga të punësuarit e tij. Këshilli i Drejtimit organizon kontrollin për mbajtjen e regjistrave profesionalë dhe të dosjeve nga ekspertët kontabël të regjistruar. Mosmbajtja si duhet e dosjeve dhe e regjistrave profesionalë, përbën shkak për ndalim të përkohshëm të ushtrimit të profesionit dhe për procedime të mëtejshme disiplinore.
- 20.2.8 Një anëtar i institutit nuk mund të bashkëpunojë me një ekspert kontabël të regjistruar, ndaj të cilit është marrë një masë disiplinore që përmban ndalimin

e ushtrimit të profesionit ose pezullimin e përkohshëm gjatë kohës kur eksperti subjekt i ndëshkimit është duke vuajtur dënimin.

- 20.2.9 Anëtari i institutit nuk mund të marrë pjesë në drejtim apo administrimin e më shumë se një firme auditimi (shoqërie të ekspertëve kontabël të regjistruar) të njohur nga instituti, e cila ushtron veprimtarinë e saj në Shqipëri.
- 20.2.10 Anëtarët e institutit persona fizikë dhe firma të auditimit janë të detyruar të paguajnë çdo vit një kuotë profesionale, shuma e të cilës caktohet nga asambleja e përgjithshme e anëtarëve. Regjistrimi në listën e publikueshme përmban detyrimin për pagimin e kuotës brenda afatit të caktuar.
- 20.2.11 Licenca e ekspertit kontabël nuk lejohet të perdoret në më shumë se një entitetet (person fizik apo shoqeri) që ka si objekt auditimin ligjor dhe jo-ligjor të pasqyrave financiare.
- 20.2.12 Duke filluar nga auditimet e Pasqyrave Financiare të vitit 2012, çdo Ekspert kontabël, që është person fizik apo eksperti kontabël, ortak kryesor i angazhimit i një shoqërie auditimi, që ka mbushur kohën e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të një shoqërie prej 7 vite rresht duhet të zëvendësohet. Personi fizik apo ortaku i angazhimit i shoqërisë së auditimit mund të rimarrë pjesë në auditimin e pasqyrave financiare të kësaj shoqërie vetëm pas mbarimit të një afati kohor prej të paktën, dy vite rresht.

### **20.3 Kërcënimet dhe Masat Mbrojtëse**

- 20.3.1 Në disa rrethana mund të ndodhë që respektimi i parimeve themelore të kërcënohet nga:
- (a) Egoizmi (Interesi Vetjak);
  - (b) Vetë Rishikimi;
  - (c) Favorizimi (Përkrahja);
  - (d) Familiariteti; dhe
  - (e) Frikësimi.

Këto kërcënime janë trajtuar në mënyrë më të plotë në Pjesën A të këtij Kodi. Natyra dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë në varësi të faktit në se ato lidhen me dhënien e shërbimeve (i) **për një klient që i auditohen pasqyrat financiare** (klient auditimi); (ii) **për një klient që i jepet siguria, por nuk i auditohen pasqyrat financiare**, ose (iii) **për një klient tjetër që nuk i jepet shërbimi i sigurisë.**

20.3.2 Shembuj të rrethanave të cilat, për një ekspert kontabël të regjistruar, mund të krijojnë kërcënime të egoizmit, por pa u kufizuar vetëm në këto, janë:

- Ekzistenca e një interesi financiar tek një klient apo edhe zotërimi së bashku me një klient i një interesi financiar të përbashkët.
- Varësia e tepruar nga shuma e honorareve të pagesave që merren nga një klient i vetëm.
- Ekzistenca e një marrëdhënie të ngushtë biznesi me një klient.
- Shqetësimi që krijohet për humbjen e mundëshme të një klienti.
- Punësimi potencial (në të ardhmen) tek një klient.
- Llogaritja e honorareve të pagesave për kryerjen e një angazhimi të dhënies së sigurisë, mbi baza të kushtëzuara.
- Dhënia apo marrja e një huaje nga një klient apo nga drejtorët dhe nëpunësit e tij.

20.3.3 Shembuj të rrethanave që mund të krijojnë kërcënimet e vetë rishikimit, por pa u kufizuar vetëm në këto, janë:

- Zbulimi i një gabimi të rëndësishëm gjatë rivlerësimit të punës nga vetë eksperti kontabël i regjistruar.
- Raportimi lidhur me mënyrën e funksionimit të sistemeve financiare të klientit nga vetë eksperti kontabël që ka marrë pjesë në hartimin dhe zbatimin e tyre.
- Përgatitja e atyre të dhënave origjinale, që përdoren për të gjeneruar regjistrime, të cilat përbëjnë çështje për t'u shqyrtuar në kuadrin e një angazhimi.
- Një anëtar i grupit të angazhimit është, ose kohët e fundit ka qënë një nga drejtorët apo nëpunësit e klientit, të cilit i jepet shërbimi.
- Një anëtar i grupit të angazhimit është, ose kohët e fundit ka qënë, i punësuar tek një klient në një pozicion me influencë direkte e të rëndësishme mbi çështjen në fjalë që është objekt i angazhimit.
- Kryerja e një shërbimi për një klient, i cili ka ndikim të drejtëpërdëjtë në çështjen në fjalë të angazhimit për dhënien së sigurisë,
- Bazueshmëria e një shërbimi të auditimit të pasqyrave financiare, në një masë të konsiderueshme tek rezultatet e rishikimeve periodike të

pasqyrave financiare të përmbledhura dhe të auditimit të brendshëm, që kryhen nga vetë eksperti kontabël i regjistruar ose firma e auditimit.

20.3.4 Shembuj të rrethanave që mund të krijojnë kërcënimin e favorizimit (përkrahjes), por pa u kufizuar vetëm në këto, janë:

- Favorizimi që ju bëhet aksioneve të një shoqërie të listuar kur kjo është një klient të cilit eksperti kontabël i regjistruar i auditon pasqyrat financiare.
- Përfaqësimi nga eksperti kontabël në rolin e avokatit, në zgjidhjen e çështjeve gjyqësore, ose të mosmarrëveshjeve me palët e treta, në emër të një klienti në të cilin ai kryen një angazhim të dhënies së sigurisë.

20.3.5 Shembuj të rrethanave që mund të krijojnë kërcënimet e familiaritetit por pa u kufizuar vetëm në këto, janë:

- Një anëtar i një grupi të angazhimit ka një marrëdhënie familjare të drejtëpërdrejtë ose të afërt me një drejtor apo nëpunës të klientit.
- Një anëtar i një grupi të angazhimit ka një marrëdhënie familjare të drejtëpërdrejtë ose të afërt me një punonjës të një klienti, i cili është në një pozicion ku ushtron influencë direkte dhe të rëndësishme mbi çështjen në fjalë të angazhimit.
- Një ish partner i firmës ka qënë drejtor, nëpunës, apo një i punësuar i klientit në një pozicion ku ka ushtruar influencë direkte dhe të rëndësishme mbi çështjen në fjalë të angazhimit.
- Pranimi i dhuratave apo i trajtimit preferencial nga një klient.
- Lidhja e një drejtuesi kryesor të firmës së auditimit për një kohë të gjatë me klientin që i jepet shërbimi i sigurisë.

20.3.6 Shembuj të rrethanave që mund të krijojnë kërcënimin e frikësimit, por pa u kufizuar vetëm në këto, janë:

- Kërcënimi me largim ose zëvendësim të ekspertit kontabël të **regjistruar** nga angazhimi i tij tek një klient.
- Kërcënimi me padi gjyqësore.
- Presioni për të zvogëluar në mënyrë të papërshtatëshme nivelin e punës së kryer, me qëllim që të zvogëlohen honoraret e pagesës.

20.3.7 Një ekspert kontabël i regjistruar mundet, gjithashtu, të konstatojë se ka rrethana të tjera specifike, që çojnë në kërcënimet unike ndaj respektimit të një

ose më shumë parimeve themelore. Nuk është e mundur që të gjitha këto kërcënime të klasifikohen në mënyrë të dukshme. Për këtë arsye ndaj këtyre rrethanave e kërcënimeve, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të jetë gjithmonë vigjilent.

20.3.8 Masat mbrojtëse, të cilat mund të eliminojnë ose zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të ulët të pranueshëm ndahen në dy kategori të mëdha:

(a) Masat mbrojtëse që krijohen nga profesioni, nga legjislacioni apo nga rregullat; dhe

(b) Masat mbrojtëse që vendosen në mjedisin e punës.

20.3.9 Masat mbrojtëse që vendosen në mjedisin e punës, ndryshojnë sipas rrethanave. Në këto masa mbrojtëse përfshihen (i) masat mbrojtëse që janë të përgjithëshme, dhe (ii) masat mbrojtëse që i përkasin një angazhimi të veçantë. Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të ushtrojë gjykimin e tij për të përcaktuar mënyrën më të mirë të trajtimit të një kërcënimi të identifikuar. Gjatë ushtrimit të gjykimin, një ekspert kontabël i regjistruar, duhet të mbajë parasysh atë ç'ka do të vlerësohet si e pranueshme nga një palë e tretë e informuar dhe arsyeshme, e cila ka njohuri për të gjitha informacionet përkatëse, përfshirë këtu rëndësinë e kërcënimit dhe të masave mbrojtëse që duhen zbatuar. Ky vlerësim do të ndikohet nga çështje të tilla, siç janë serioziteti i kërcënimit, natyra e angazhimit dhe struktura e firmës.

20.3.10 Në masat mbrojtëse të përgjithëshme, që vendosen në mjedisin e punës, të cilat i shërbejnë firmës së auditimit bëjnë pjesë:

- Lidërshipi i firmës thekson rëndësinë e respektimit të parimeve themelore dhe përforcon besimin se anëtarët e grupit të dhënies së sigurisë do të veprojnë në interes të publikut.
- Venia në funksionim e politikave dhe procedurave që shërbejnë për të zbatuar e monitoruar kontrollin e cilësisë së angazhimeve.
- Vendosija e politikave të dokumentuara që shërbejnë: për të identifikuar kërcënimet që i bëhen respektimit të parimeve themelore, për vlerësimin e rëndësisë së kërcënimeve dhe për identifikimin e zbatimit e atyre masave mbrojtëse, të cilat eliminojnë apo zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm, përveç rasteve kur kërcënimet janë krejt të parëndësishme.
- Në rastin e firmave që kryejnë angazhime të dhënies së sigurisë, vendosja në funksionim e atyre e politikave që dokumentojnë pavarësinë, të cilat shërbejnë për identifikimin e kërcënimeve që i bëhen pavarësisë, vlerësimin e rëndësisë së këtyre kërcënimeve, si edhe vlerësimin e zbatimit e masave mbrojtëse që i eliminojnë apo zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm, përveç atyre kërcënimeve që janë krejt të parëndësishme.

- Vendosja e politikave dhe procedurave të brendëshme të dokumentuara, që kërkojnë respektimin e parimeve themelore.
- Vendosja e politikave dhe procedurave që bëjnë të mundur identifikimin e interesave ose marrëdhënieve që ekzistojnë midis firmës apo anëtarëve të grupeve të angazhimit dhe klientëve.
- Përdorimi i partnerëve të ndryshëm dhe i grupeve të ndryshme të angazhimit me linja të veçanta raportimi, për dhënien e shërbimeve të jo-sigurisë për një klient që eksperti kontabël i regjistruar i jep shërbimin e sigurisë.
- Vendosja e politikave dhe procedurave, të cilat ndalojnë individët, që s`janë anëtarë të një grupi të angazhimit, të influencojnë në mënyrë të përshtatëshme rezultatin e angazhimit.
- Komunikimi në kohë i politikave dhe procedurave të një firme, përfshirë ndryshimet që bëhen, për të gjithë partneret e stafin tjetër profesional dhe trainimi e formimi i duhur për zbatimin e këtyre politikave e procedurave.
- Caktimi i një anëtari të nivelit të lartë të drejtimit me përgjegjësinë për të mbikëqyrur funksionimin e duhur të sistemit të kontrollit të cilësisë të firmës.
- Informimi i partnerëve dhe i stafit profesional për ato klientë që ju jepet siguria dhe për entitetet përkatëse, nga të cilët ata duhet të jenë të pavarur.
- Vendosja e një mekanizmi disiplinor që nxit respektimin e politikave dhe procedurave.
- Vendosja e politikave dhe procedurave të publikuara, që shërbejnë për të inkurajuar dhe për t`i dhënë pushtet personelit të firmës së auditimit, me qëllim që ai të komunikojë me nivelet e larta brenda firmës, për çdo çështje shqetësuese që ka lidhje me respektimin e parimeve themelore.

20.3.11 Në masat mbrojtëse të mjedisit të punës, të cilat ju përkasin angazhimeve specifike, mund të bëjnë pjesë:

- Përfshirja e një eksperti kontabël të regjistruar tjetër për të rishikuar punën e bërë ose, për të dhënë këshilla sipas nevojës.
- Konsultimi me një palë të tretë të pavarur, siç mund të jetë një komitet i pavarur i drejtorëve, një organizmi profesional ose rregullator, apo edhe një ekspert kontabël i regjistruar tjetër.
- Diskutimi i çështjeve etike me personat që janë përgjegjës për qeverisjen e klientit.

- Informimi i personave të ngarkuar me qeverisjen e klientit lidhur me natyrën e shërbimeve dhe nivelin e honorareve të faturuara.
- Përfshirjen e një firme tjetër për të kryer apo përsëritur disa pjesë të angazhimit.
- Rotacioni i arsyeshëm i personelit kryesor drejtues të grupit të dhënies së sigurisë.

20.3.12 Në varësi të natyrës së angazhimit, një ekspert kontabël i regjistruar mundet, gjithashtu, të mbështetet në masat mbrojtëse që zbaton klienti. Megjithatë, për të zvogëluar kërcënimet në një nivel të pranueshëm, nuk është e mjaftueshme që të bazohesh vetëm në këto masa mbrojtëse.

20.3.13 Në masat mbrojtëse të vendosura brenda sistemeve dhe procedurave të klientit mund të përfshihen:

- Procedurat e klientit lidhur me emërimin e ekspertit kontabël të regjistruar apo të firmës së auditimit për kryerjen e një angazhimi, të cilat përfshijnë edhe kërkesën për ratifikimin apo aprovimin e këtij emërimi nga persona të tjerë që nuk kanë lidhje me angazhimin.
- Për marrjen e vendimeve menaxheriale klienti cakton punonjës të niveleve të duhura të drejtimit, të cilët janë kompetentë dhe kanë eksperiencë.
- Klienti ka një strukturë qeverisëse, e cila garanton mbikëqyrjen dhe komunikimin e duhur të shërbimeve të firmës.

## **21. Emërimi i Ekspertit Kontabël të Regjistruar**

### **21.1 Pranimi i Klientit**

21.1.1 Përpara se të pranojë një marrëdhënie me një klient, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të vlerësojë faktin nëse ky pranim do të krijonte ndonjë kërcënim ndaj respektimit të parimeve themelore. Kërcënimet potenciale ndaj integritetit ose sjelljes profesionale mund të krijohen, për shembull, nga çështje të diskutueshme që lidhen me klientin (pronarët, drejtimin dhe veprimtaritë e tij).

21.1.2 Në çështjet e diskutueshme të klientit që, po qe se njihen, do të mund të kërcënonin respektimin e parimeve themelore përfshihen, për shembull, rastet kur klienti merret me një veprimtari ilegale (siç është pastrimi i parave), pandershmëria apo edhe praktikrat e raportimeve financiare të dyshimta.

21.1.3 Rëndësia e çdo kërcënimi duhet të vlerësohet. Në se kërcënimet e identifikuar nuk janë krejt të parëndësishme, atëherë sipas nevojës, duhet të merren



parasysh e të zbatohen ato masa mbrojtëse që i eliminojnë ose zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm.

- 21.1.4 Në masat e duhura mbrojtëse mund të përfshihet njohja e klientit dhe e veprimtarisë së tij, e pronarëve, drejtuesve dhe atyre që janë përgjegjës për qeverisjen, marrja e garancisë nga klienti se ai do të përmirësojë praktikën e qeverisjes të shoqërisë tregtare ose sistemin e kontrolleve të brendëshme.
- 21.1.5 Atje ku nuk ka mundësi që kërcënimet të zvogëlohen deri në një nivel të pranueshëm, një ekspert kontabël i regjistruar nuk duhet të pranojë që të hyjë në marrëdhënie me klientin.
- 21.1.6 Vendimet e pranimit të angazhimeve me klientin, të cilat përsëriten, duhet t'i nënshtrohen rishikimit periodik.

## **21.2 Pranimi i Angazhimit**

- 21.2.1 Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të pranojë të japë vetëm ato shërbime, për të cilat ai ka kompetencën e duhur për t'i kryer. Përpara se të pranojë një angazhim për një klient specifik, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të vlerësojë faktin nëse pranimi do të krijonte kërcënime ndaj respektimit të parimeve themelore. Për shembull, një kërcënim i egoizmit, kundrejt kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur, mund të krijohet në qoftë se grupi i angazhimit nuk zotëron, apo nuk ka mundësi të sigurojë kompetencën e nevojshme për të kryer siç duhet angazhimin.
- 21.2.2 Përpara se të marrë në ngarkim një angazhim të ri, eksperti kontabël i regjistruar duhet të njoftojë më shkrim presidentin e IEKA-s.
- 21.2.3 Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të vlerësojë rëndësinë e kërcënimeve të identifikuar, dhe nëse ato nuk janë krejt të parëndësishme, ai duhet të zbatojë masat e nevojshme mbrojtëse për eliminimin apo zvogëlimin e tyre në një nivel të pranueshëm. Në këto masa mbrojtëse bëjnë pjesë:
- Sigurimi i njohjes së duhur për natyrën e veprimtarisë së biznesit që kryen klienti, kompleksitetin e operacioneve të tij, kërkesat specifike të angazhimit dhe qëllimin, natyrën e objektin e punës që duhet të kryhet.
  - Njohja e sektorëve përkatës të ekonomisë dhe e çështjeve që do të trajtohen.
  - Zotërimi apo sigurimi i eksperiencës lidhur me kërkesat rregullatore apo të raportimit.
  - Caktimi i atij personeli që ka kompetencën e duhur profesionale.
  - Përdorimi i ekspertëve kur kjo është e nevojshme.

- Pranimi i kryerjes së angazhimit brenda një periudhe kohe realiste.
- Respektimi i politikave dhe procedurave të kontrollit të cilësisë, të cilat synojnë dhënien e sigurisë se angazhimet specifike do të pranohen vetëm atëhere kur ato mund të kryhen me kompetencë.

### **21.3 Angazhimet e Përbashkëta**

- 21.3.1 Ne disa rrethana, të parashikuara nga ligji për shoqëritë tregtare, për kryerjen e një angazhimi auditimi për një klient mund të caktohen më shumë se një ekspert kontabël i regjistruar. Ekspertët kontabël të emëruar bashkërisht për kryerjen e angazhimit të auditimit tek një klient duhet të jenë të pavarur nga klienti dhe midis tyre
- 21.3.2 Kryerja e përbashkët e një angazhimi auditimi për një klient kërkon që ekspertët kontabël të bashkëemëruar të hartojnë dhe miratojnë një plan pune të përbashkët të detajuar, që përcakton mënyrën e kryerjes së angazhimit dhe shpërndarjen në mënyrë të drejtë të punës midis tyre. Secili prej ekspertëve kontabël të regjistruar ka përgjegjësinë për përgatitjen e dosjes për pjesën e punës së kryer prej tij, si edhe për respektimin e parimeve themelore.
- 21.3.3. Nuk mund të jenë bashkëekspertë kontabël të regjistruar për kryerjen e një angazhimi auditimi tek një klient, personat që i përkasin të njëjtës firmë auditimi apo edhe një ekspert kontabël i regjistruar person fizik dhe firma e auditimit ku ai bën pjesë.

### **21.4 Ndryshimi Emërimit**

- 21.4.1 Një ekspert kontabël i regjistruar, që thirret për të zëvendësuar një ekspert tjetër, ose që vendos të marrë pjesë në një tender për kryerjen e një angazhimi që aktualisht mbahet nga një ekspert kontabël i regjistruar tjetër, nuk duhet të pranojë angazhimin, po qe se ekzistojnë arsye profesionale apo edhe arsye të tjera për mospranimin e angazhimit, siç janë rrethanat që kërcënojnë respektimin e parimeve themelore. Për shembull, kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur mund të kërcënohen në qoftë se një ekspert kontabël i regjistruar e pranon angazhimin para se ai të ketë njohur faktet përkatëse.
- 21.4.2 Anëtari i institutit, që thirret nga një klient për të zëvendësuar një ekspert kontabël të regjistruar tjetër, mund ta pranojë angazhimin vetëm pasi të jetë informuar me shkrim nga ky i fundit dhe pasi të jetë siguruar që kërkesa nuk rrjedh nga dëshira e klientit për të shmangur efektet e kryerjes rigoroze të detyrave profesionale nga ana e paraardhësit, siç janë këmbëngulja për të zbuluar të vërtetën, për të respektuar veten dhe për të kërkuar respektimin e ligjeve në punët e tij. Ai duhet të mënjanojë çdo kritikë personale ndaj paraardhësit.

- 21.4.3 Para se të hyjë në funksion, për kryerjen e një angazhimi të auditimit të pasqyrave financiare, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të ketë marrë nga klienti një dokument që përlligj pagimin nga klienti të honorareve për paraardhësit të tij, kur ato janë bazuar në një marrëveshje qartësisht të përcaktuar, ose kur i përgjigjen tabelës së hartuar nga instituti për punimet e kryera, dhe kur zbatimi i këtyre punimeve nga paraardhësit nuk ka qënë kundërshtuar nga klienti. Nëqoftëse nuk është kështu, ai mund të fillojë funksionin e tij, pasi t'i ketë referuar çështjen presidentit të institutit dhe të ketë shfaqur rezervat e nevojshme pranë klientit të tij.
- 21.4.4 Rëndësia e kërcënimeve duhet të vlerësohet. Në varësi të natyrës së angazhimit, dhe me qëllim që të provohen faktet dhe rrethanat që qëndrojnë pas ndryshimit që propozohet, mund të kërkohet komunikimi i drejtëpërdrejtë me ekspertin kontabël ekzistues. Kjo i jep mundësi ekspertit kontabël të regjistruar të gjykojë faktet dhe të përcaktojë në se është e përshtatëshme që ai të pranojë ose jo angazhimin.
- 21.4.5 Një ekspert kontabël i regjistruar ekzistues është i detyruar të mbajë kofidencialitetin. Shkalla deri në të cilën ky i fundit mundet dhe duhet të diskutojë me ekspertin kontabël të propozuar, për veprimtaritë e klientit, do të varet nga natyra e angazhimit dhe në:
- (a) Faktin nëse klienti ka dhënë ose jo leje për të komunikuar; ose
  - (b) Kërkesat ligjore dhe etike që lidhen me këto komunikime e paraqitje.
- 21.4.6 Në mungesë të instruksioneve specifike të dhëna nga klienti, një ekspert kontabël i regjistruar ekzistues, si rregull, nuk duhet të japë vullnetarisht informacione për veprimtaritë e klientit. Rrethanat se kur mund të jetë e përshtatëshme të zbulohen informacionet konfidenciale janë dhënë në paragrafin 11.4.7 të pjesës A të këtij Kodi.
- 21.4.7 Në qoftë se kërcënimet e identifikuar nuk janë krejt të parëndësishme, atëhere duhen konsideruar e zbatuar ato masa mbrojtëse të domosdoshme, të cilat eliminojnë ose pakësojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm.
- 21.4.8 Në këto masa mbrojtëse mund të përfshihen:
- Diskutimi plotësisht dhe lirshëm me ekspertin kontabël ekzistues për problemet e klientit;
  - Kërkesa ndaj ekspertit kontabël ekzistues që ai të japë informacione për faktet ose rrethanat, të cilat sipas opinionit të këtij të fundit, eksperti kontabël i propozuar duhet t'i dijë përpara se të marrë vendimin në se do të pranojë ose jo angazhimin;
  - Kur i përgjigjet një ftese për ofertë për të marrë pjesë në një tender, eksperti kontabël i propozuar duhet që në ofertën e dhënë të deklarojë se

përpara pranimit të angazhimit, ai do të kërkojë të kontaktojë me ekspertin kontabël ekzistues, për të marrë informacion për faktin në se ka ndonjë arsye profesionale apo ndonjë arsye tjetër pse nuk duhet pranuar emërimi.

- 21.4.9 Një ekspert kontabël i regjistruar si rregull, duhet të marrë leje nga klienti, preferohet me shkrim, për të filluar diskutimin me një ekspert kontabël të regjistruar ekzistues. Pasi të jetë marrë leja, eksperti kontabël ekzistues duhet të respektojë ligjet dhe rregullat që kanë të bëjnë me këto kërkesa. Në dhënien e informacioneve, eksperti kontabël ekzistues duhet të jetë i ndershem dhe i qartë. Në qoftë se eksperti kontabël i propozuar nuk ka mundësi të komunikojë më ekspertin kontabël ekzistues, ai (i pari) duhet të përpiqet që të marrë informacione për ndonjë kërcënim të mundshëm, nëpërmjet rrugëve e mjeteve të tjera, siç janë kërkimet e informacioneve nga palët e treta apo edhe duke pyetur drejtuesit e lartë ose personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit.
- 21.4.10 Në qoftë se, me gjithë zbatimin e masave mbrojtëse, kërcënimet nuk mund të eliminohen apo zvogëlohen në një nivel të pranueshëm, një ekspert kontabël i regjistruar, me përjashtim të rasteve kur krijon bindje për faktet e nevojshme nëpërmjet mjeteve të tjera, duhet të heqë dorë nga angazhimi.
- 21.4.11 Një eksperti kontabël të regjistruar mund t'i kërkohej që të kryejë një punë që është plotësuese apo shtesë e punës që kryen ekspertin kontabël ekzistues. Këto rrethana mund të çojnë në kërcënime potenciale ndaj kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur, të cilat rrjedhin, për shembull, nga mungesa apo nga paplotësia e informacioneve. Në masat mbrojtëse që merren kundër këtyre kërcënimeve bën pjesë informimi i ekspertit kontabël ekzistues për punën e propozuar, që do ta mundësonte këtë të fundit të jepte çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e punës siç duhet.

## **22. Konfliktet e Interesit**

- 22.1 Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshëm për të identifikuar ato rrethana që mund ta përballin atë me një konflikt interesi. Këto rrethana mund të çojnë në kërcënime kundrejt respektimit të parimeve themelore. Për shembull, një kërcënim ndaj objektivitetit mund të krijohet kur një ekspert kontabël i regjistruar konkuron direkt me një klient, apo ka një sipërmarrje të përbashkët, a marrëveshje të ngjashme, me një konkurent kryesor të një klienti. Një kërcënim ndaj objektivitetit ose konfidencialitetit mund të krijohet, gjithashtu, kur një ekspert kontabël i regjistruar kryen shërbime për klientët, interesat e të cilëve janë në konflikt ose kur klientët kanë mosmarrëveshje me njëri tjetrin për çështjen ose transaksionin në fjalë që është objekt i angazhimit.
- 22.2 Eksperti kontabël i regjistruar duhet të vlerësojë rëndësinë e çdo kërcënimi Vlerësimi duhet bërë qoftë para pranimit ashtu edhe për vazhdimin e marrëdhënies apo të një angazhimi të veçantë me një klient, idhur me faktin në se eksperti kontabël ka interesa biznesi apo marrëdhënie me klientin ose me

një palë të tretë, që mund të çojnë në kërcënime. Në qoftë se kërcënimet nuk janë krejt të parëndësishme, atëhere duhen të merren parasysh dhe të zbatohen ato masa mbrojtëse të nevojshme, të cilat i eliminojnë kërcënimet ose i zvogëlojnë ato në një nivel të pranueshëm.

22.3 Në masat mbrojtëse që duhet të zbatojë një ekspert kontabël i regjistruar, në varësi të rrethanave që çojnë në konflikt, si rregull do të përfshihen:

- (a) Njoftimi i klientit lidhur me interesat e biznesit që ka firma e auditimit ose për veprimtaritë që mund të paraqesin konflikt interesi dhe marrja e pëlqimit prej klientit në se duhet vepruar ose jo në këto rrethana; ose
- (b) Njoftimi i të gjitha palëve përkatëse të njohura, se eksperti kontabël i regjistruar po vepron për dy ose më shumë palë, për një çështje ku interesat e tyre respektive janë në konflikt, dhe marrja e pëlqimit prej tyre për të vepruar; ose
- (c) Njoftimi i klientit se eksperti kontabël i regjistruar, në dhënien e shërbimeve të propozuara (për shembull në një sektor të veçantë të tregut ose në lidhje me një shërbim specifik), nuk vepron në mënyrë ekskluzive vetëm për një klient; dhe marrja e pëlqimit për të vepruar.

22.4 Gjithashtu, duhet të merren në konsideratë edhe masat mbrojtëse që jepen në vijim:

- (a) Përdorimi i grupeve të angazhimit të veçanta; dhe
- (b) Venia në funksionim e procedurave që parandalojnë të drejtën e hyrjes në informacione (për shembull ndarja fizike strikte e këtyre grupeve, regjistrimet e të dhënave në dosje në mënyrë konfidenciale dhe të sigurtë); dhe
- (c) Hartimi i udhëzimeve të qarta për anëtarët e grupit të angazhimit lidhur me çështjet e sigurisë dhe të konfidencialitetit; dhe
- (d) Përdorimi i formateve standarde të marrëveshjeve për ruajtjen e konfidencialitetit, të cilat nënshkruhen nga punonjësit dhe partnerët e firmës; dhe
- (e) Rishikimi i vazhdueshëm i zbatimit të masave mbrojtëse, nga individët në nivelet e sipërme të drejtimit, të cilët nuk lidhen direkt me kryerjen e angazhimeve me klientin.

22.5 Në rastin kur kemi të bëjmë me një konflikt interesi që paraqet kërcënim për një ose më shumë parime themelore, përfshirë objektivitetin, konfidencialitetin ose sjelljen profesionale i cili, megjithëse zbatohen masa mbrojtëse, nuk mund të eliminohet apo zvogëlohet në një nivel të pranueshëm, eksperti kontabël i

regjistruar nuk duhet të pranojë anagazhimin, pa bërë më parë dorëheqje nga një ose disa marrëveshje që kanë konflikt.

- 22.6 Kur një ekspert kontabël i regjistruar i ka kërkuar një klienti pëlqimin për të vepruar për një palë tjetër (që mund të jetë ose jo një klient ekzistues), në një çështje ku interesat respektive janë në konflikt, dhe ky pëlqim nuk është dhënë, atëhere eksperti kontabël i regjistruar nuk duhet të vazhdojë të veprojë për njërin nga palët në çështjen që çon në konflikt interesi.

### **23 Opinionet Dytësore**

- 23.1 Situatat, në të cilat një ekspert kontabël i regjistruar kërkohet të japë një opinion dytësor lidhur me zbatimin e standardeve të kontabilitetit, auditimit, raportimit ose të standardeve apo parimeve të tjera, sipas rrethanave specifike apo për transaksionet e kryera nga ose në emër të një shoqërie a entiteti që nuk është një klient ekzistues, mund të çojnë në kërcënime të respektimit të parimeve themelore. Për shembull, mund të ketë një kërcënim ndaj kompetencës profesionale dhe kujdesit të duhur në rrethanat kur opinionin dytësor nuk është bazuar në të njëjtën seri faktesh që kanë qënë qënë disponibël për ekspertin kontabël ekzistues, ose kur ky opinion është bazuar në një evidencë që është e pamjaftueshme. Rëndësia e kërcënimit do të varet nga rrethanat në të cilat bëhet kërkesa për dhënien e opinionëve dytësore dhe nga faktet e supozimet e tjera të mundëshme, që lidhen me shprehjen e një gjykimi profesional.
- 23.2 Kur një ekspert kontabël i regjistruar kërkohet të japë një opinion të tillë, ai duhet të vlerësojë rëndësinë e kërcënimeve dhe, në qoftë se ato nuk janë krejt të parëndësishme, ai duhet të mbajë parasysh e të zbatojë ato masa mbrojtëse të nevojshme, që i eliminojnë apo i zvogëlojnë kërcënimet në një nivel të pranueshëm. Në këto masa mund të përfshihet kërkimi i lejes prej klientit për të kontaktuar ekspertin kontabël ekzistues, përshkrimi i kufizimeve që shoqërojnë opinionin për komunikimet me klientin dhe dhënia e një kopje të opinionit ekspertit kontabël ekzistues.
- 23.3 Në qoftë se entiteti që kërkon opinionin nuk lejon komunikimin me ekspertin kontabël ekzistues, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të vlerësojë, në varësi të rrethanave, në se është e përshtatëshme që ai të japë ose jo opinionin që kërkohet.

### **24. Honoraret dhe Shpërblimet**

- 24.1 Kur një ekspert kontabël i regjistruar hyn në negociata për të dhënë shërbime profesionale, ai mund të caktojë një honorar që atij i duket i përshtatshëm.
- 24.2 Shuma e honorareve vendoset në marrëveshje midis ekspertëve kontabël të autoprizuar dhe klientëve, por gjithnjë duke respektuar parashikimin e

rregullave të profesionit. Ajo duhet të jetë e arsyeshme dhe të përbëjë një shpërblim të drejtë për punën ose shërbimet e kryera, përfshirë nivelin e vështirësisë teknike që paraqesin çështjet që duhen zgjidhur, duke patur parasysh cilësinë e tyre, titullin, emrin e mirë dhe përgjegjësinë morale e materiale të anëtarit të institutit.

- 24.3 Honoraret nuk mund të caktohen në asnjë rast në varësi nga rezultati financiar i klientit apo me ndërhyrje të anëtarëve të institutit. Honoraret paguhen në të holla dhe përjashtojnë çdo formë tjetër shpërblimi.
- 24.4 Një ekspert kontabël i regjistruar i pavarur nuk lejohet të përdorë zbatimin e tarifave të ulëta për qëllime të sigurimit të klientelës së tij. Atij i ndalohet gjithashtu të paguajë ose të marrë honorare referuese apo çfaredo komisioni referues.
- 24.5 Veprimtaria e anëtarëve të institutit ose e firmave të auditimit të njohura prej tij nuk mund t'i kushtohet në pjesën më të madhe një shoqërie të vetme, një grupi financiar, ose vetëm një bashkësie interesash. Ky prag quhet i arritur kur shpërblimi, që merret nga eksperti ose firma e auditimit, tejkalon 50 për qind të të ardhurave të përgjithëshme vjetore të tyre.
- 24.6 Fakti që një ekspert kontabël i regjistruar mund të caktojë një honorar me të ulët se një profesionist tjetër, në vetvete nuk është jo etik. Megjithatë, niveli i honorareve të kuotuar mund të çojë në kërcënime ndaj respektimit të parimeve themelore. Për shëmbull, mund të krijohet një kërcënim i egoizmit për kompetencën profesionale dhe kujdesin e duhur në qoftë se honorari është kuotuar aq i ulët sa që do të jetë vështirë që angazhimi të kryhet në pajtim me standardet profesionale dhe teknike që janë të detyrueshme për t'u zbatuar.
- 24.7 Rëndësia e këtyre kërcënimeve do të varet nga faktorë të tillë si niveli i honorarit të kuotuar dhe shërbimet për të cilat ai zbatohet. Në dritën e këtyre kërcënimeve të mundëshme duhen mbajtur parasysh dhe zbatuar masat mbrojtëse të nevojshme për t'i eliminuar, ose zvogëluar kërcënimet në një nivel të pranueshëm, ku bëjnë pjesë:
- Vënia në dijeni e klientit për kushtet e angazhimit dhe veçanërisht, për bazën mbi të cilën janë llogaritur honoraret, si edhe për llojet e shërbimeve që mbulohen nga ky honorar.
  - Planifikimi i duhur i kohës dhe caktimi i personelit të kualifikuar për kryerjen e punës.

## **25. Reklamimi i Shërbimeve Profesionale**

- 25.1 Anëtarët e Institutit kanë të drejtë të bëjnë të njohur titujt dhe diplomat e lëshuara nga shteti, apo nga një shkollë shtetërore ose private e njohur nga shteti. Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar mund të bëjë ose të

autorizojë çdo publikim kolektiv që ai e gjykon të dobishëm në interes të profesionit.

25.2 Në çdo rast që një ekspert kontabël i regjistruar bën reklamim brenda kufijve të vendosur në paragrafin 25.1, ai nuk duhet të diskreditojë profesionin. Eksperti kontabël i regjistruar duhet të jetë i ndershëm dhe i sinqertë dhe nuk duhet:

- Të bëjë publicitet personal dhe çdo pazarllëk me qëllim konkurrence profesionale
- Të bëjë paraqitje të ekzagjeruara për kualifikimet që zotëron, apo për eksperiencën që ka fituar; ose
- Të bëjë referime nënçmuese apo krahasime të pa provuara me punën e të tjerëve.

25.3 Anëtarëve të institutit u ndalohet të kërkojnë klientelë me anë të: zbatimit të tarifave të ulëta (që nuk garantojnë kryerjen e punës në pajtim me standardet teknike e profesionale të zbatueshme), akordimit klientëve ose të tretëve zbritje nga honoraret, kryerjes së veprimeve me karakter pazarllëku në çfarëdo formë që të jetë, personalisht apo nëpërmjet personave të tjerë, për llogari të tyre ose për llogari të të tretëve. Atyre u ndalohet gjithashtu, të bëjnë konferenca që kanë karakter publikimi.

## **26. Dhuratat dhe Mikëpritja**

26.1 Ekspertit kontabël të regjistruar ose një anëtari të ngushtë apo të drejtëpërdrejtë të familjes së tij, mund t'i ofrohen nga një klient dhurata dhe mikëpritje, të tilla që mund të çojnë në kërcënimin e respektimit të parimeve themelore. Për shembull, në qoftë se nga një klient pranohet një dhuratë, atëhere objektiviteti mund të kërcënohet nga egoizmi, po kështu ai mund të kërcënohet edhe nga frikësimi që lind nga fakti që këto oferta mund të të bëhen publike.

26.2 Rëndësia e këtyre kërcënimeve do të varet nga natyra, vlera dhe qëllimi që qëndron pas ofertës. Në rastin kur janë bërë dhurata apo është dhënë mikëpritje, që një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, e cila ka njohuri për informacionet përkatëse, do t'i konsideronte si krejt të parëndësishme, eksperti kontabël i regjistruar mund të arrijë në përfundimin se oferta është bërë në kushtet normale të biznesit dhe nuk paraqet ndonjë qëllim specifik për të influencuar vendimarrjen ose për të marrë informacion. Në këto raste, eksperti kontabël i regjistruar mundet, që përgjithësisht, të arrijë në përfundimin se nuk kemi të bëjmë me një kërcënim të rëndësishëm kundrejt respektimit të parimeve themelore.



26.3 Në qoftë se kërcënimet e vlerësuara nuk janë krejt të parëndësishme, atëhere duhet që merren parasysh e zbatohen masat e nevojshme mbrojtëse për t'i eliminuar ose zvogëluar ato në një nivel të pranueshëm. Në rastin kur kërcënimet, me gjithë zbatimin e masave të nevojshme mbrojtëse, nuk mund të eliminohen ose zvogëlohen në një nivel të pranueshëm, një ekspert kontabël i regjistruar nuk duhet t'i pranojë këto oferta.

## **27. Marrja në Ruajtje (në Kujdestari) e Aktiveve të Klientit**

27.1 Një ekspert kontabël i regjistruar nuk duhet të marrë në ruajtje paratë e një klienti apo edhe aktive të tjera të tij, përveç rasteve kur kjo lejohet me ligj dhe në këto raste, vetëm në pajtim me detyrimet ligjore shtesë, që e obligojnë ekspertin kontabël të regjistruar të mbajë këto aktive.

27.2 Mbajtja e aktiveve të klientit krijon kërcënime ndaj respektimit të parimeve themelore; për shembull ekziston një kërcënim i egoizmit kundrejt sjelljes profesionale; po kështu, mund të ketë edhe një kërcënim të egoizmit kundrejt objektivitetit, të cilët lindin nga mbajtja e aktiveve të klientit. Për të marrë masa mbrojtëse kundrejt këtyre kërcënimeve, një ekspert kontabël i regjistruar, të cilit i janë besuar paratë (apo aktivet e tjera) që ju përkasin të tjerëve, duhet:

- (a) T'i mbajë këto aktive veças aktiveve të tij personale, apo të firmës së auditimit;
- (b) Të përdorë këto aktive vetëm për qëllimet, për të cilat ato janë parashikuar;
- (c) Gjatë gjithë kohës, të jetë në gjendje të japë llogari për këto aktive, për të ardhurat dhe dividendët, apo të ardhura të tjera të gjeneruara, për çdo person që ka të drejta ndaj tyre; dhe
- (d) Të respektojë të gjitha ligjet dhe rregullat përkatëse për mbajtjen dhe kontabilizimin e këtyre aktiveve.

27.3 Veç kësaj, ekspertët kontabël të regjistruar duhet të jenë në dijeni të kërcënimeve që i bëhen respektimit të parimeve themelore, të cilat vijnë nga lidhja me këto aktive, për shembull, në qoftë se aktivet e kanë burimin nga veprimtari të paligjshme, siç është për shembull pastrimi i parave. Në procedurat e pranimit të klientit dhe të angazhimit për kryerjen e këtyre shërbimeve, që përdor një ekspert kontabël i regjistruar, bëjnë pjesë edhe kërkimi i informacioneve lidhur me burimin e këtyre aktiveve dhe vlerësimi i detyrimeve ligjore e rregullatore të tyre.

## **28 Objektiviteti – Të Gjitha Shërbimet**

- 28.1 Gjatë dhënies së shërbimeve profesionale, një ekspert kontabël i regjistruar duhet të vlerësojë faktin në se respektimi i parimit të objektivitetit kërcënohet nga ekzistenca e interesave apo e marrëdhënieve me një klient ose me drejtorët, nëpunësit apo punëmarrësit e atij klienti. Për shembull, një kërcënim i familiaritetit kundrejt objektivitetit mund të krijohet nga një marrëdhënie familjare, e ngushtë, personale apo e biznesit.
- 28.4 Një ekspert kontabël i regjistruar, i cili jep një shërbim të sigurisë, duhet të jetë i pavarur nga klienti, të cilit i jepet shërbimi i sigurisë. Pavarësia në mendim dhe në dukje janë të nevojshme për të bërë të mundur që eksperti kontabël i regjistruar të shprehë dhe të duket se shpreh një konkluzion pa paragjykim, pa konflikt interesi apo influencim të tepruar nga të tjerët.
- 28.5 Ekzistenca, gjatë kryerjes së ndonjë shërbimi profesional, e kërcënimeve që i bëhen objektivitetit do të varet nga rrethanat e veçanta të angazhimit dhe nga natyra e punës që kryen eksperti kontabël i regjistruar.
- 28.6 Një ekspert kontabël i regjistruar duhet të vlerësojë rëndësinë e kërcënimeve të identifikuar dhe, në se ato nuk janë krejt të parëndësishme, ai duhet të marrë parasysh e të zbatojë masat e nevojshme mbrojtëse për t'i eliminuar apo zvogëluar kërcënimet në një nivel të pranueshëm. Këto masa mund të përfshijnë:
- Tërheqjen nga grupi i angazhimit.
  - Venien në funksionim të procedurave të mbikëqyrjes.
  - Ndërprerjen e atyre marrëdhënieve financiare apo të biznesit që çojnë në kërcënime.
  - Diskutimin e çështjes me nivelet e larta të drejtimit brenda firmës.
  - Diskutimin e çështjes me personat e ngarkuar me qeverisjen e klientit.

## **29 Pavarësia**

### **29.1 Angazhimet për Dhënien e Sigurisë**

- 29.1.1 Në rastin e një angazhimi të dhënies së sigurisë është në interes të publikut dhe për këtë arsye, kërkohet edhe nga ky Kod i Etikës, që ekspertët kontabël të regjistruar, anëtarët **e grupeve të dhënies së sigurisë**, firmat dhe, sipas rastit, edhe **firmat rrjet**, të jenë të pavarura nga klienti që i jepet shërbimi i sigurisë.
- 29.1.2 Angazhimet e dhënies së sigurisë kanë për qëllim të rritin shkallën e besueshmërisë të përdoruesve të synuar lidhur me rezultatet e vlerësimit ose

matjes të një çështjeje të dhënë kundrejt kriterëve të caktuar. Kuadri Ndërkombëtar i Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (Kuadri i Dhënies së Sigurisë), i publikuar nga IAASB, përshkruan elementet dhe objektivat që përmban një angazhim i dhënies së sigurisë dhe identifikon angazhimet në të cilat zbatohen Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA), Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve për të Rishikuar (ISRE) dhe Standardet Ndërkombëtare të Angazhimeve të Dhënies së Sigurisë (ISAE). Për të bërë një përshkrim të elementëve dhe objektivave të një angazhimi të dhënies së sigurisë referimi duhet të bëhet në Kuadrin e Dhënies së Sigurisë të IAASB-së.

29.1.3 Sikurse shpjegohet në Kuadrin e IAASB-së, në një angazhim të dhënies së sigurisë, eksperti kontabël i regjistruar shpreh një konkluzion që synon të rritë shkallën e besimit nga përdoruesit e synuar, me përjashtim të palës që është përgjegjëse për rezultatet e vlerësimit ose të matjes së një çështjeje të dhënë kundrejt një kriteri të caktuar.

29.1.4 Rezultati i vlerësimit, ose matjes të një çështjeje të dhënë, është informacioni që del nga zbatimi i kriterit për vlerësimin e kësaj çështjeje. Termi “informacioni për çështjen (në fjalë) që shqyrtohet” përdoret në kuptimin e rezultateve të vlerësimit ose të matjes së çështjes në shqyrtim. Për shëmbull:

- Marrja në llogari, vlerësimi, paraqitja dhe dhënia e informacioneve në pasqyrat financiare (informacioni për çështjen në shqyrtim) rrjedh nga zbatimi i një kuadri të caktuar të raportimit financiar lidhur me marrjen në llogari, vlerësimin, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve, ku për shëmbull Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, mund të përdoren si kriter për të bërë vlerësimin e gjendjes financiare, të performancës financiare dhe flukseve të parasë të një entiteti (çështja në fjalë).
- Një pohim që lidhet me efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm (informacioni për çështjen në shqyrtim) rrjedh nga zbatimi i kuadrit për vlerësimin e efektivitetit të kontrollit të brendshëm, ku si kriter vlerësues mund të përdoren standardet kombëtare apo ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm (çështja në fjalë)

29.1.5 Angazhimet për dhënien e sigurisë mund të bazohen në pohime ose mund të raportohen direkt. Në secilin nga këto raste ato përfshijnë tri palë: (i) ekspertin kontabël të regjistruar, (ii) palën përgjegjëse dhe (iii) përdoruesit e synuar.

29.1.6. Në një angazhim të dhënies së sigurisë që bazohet në pohim, i cili është një angazhim i auditimit të pasqyrave financiare, vlerësimi ose matja e çështjes në fjalë kryhet nga pala përgjegjëse, dhe informacioni për çështjen në fjalë është në formën e një pohimi që jepet nga pala përgjegjëse, pohim i cili u bëhet i disponueshëm përdoruesve të synuar.

29.1.7. Në një angazhim të dhënies së sigurisë që raportohet direkt, eksperti kontabël i regjistruar ose e kryen drejtëpërdrejt vlerësimin apo matjen për çështjen në fjalë, ose merr, nga pala përgjegjëse që e ka kryer vlerësimin ose matjen, një paraqitje, e cila nuk ju është vënë në dispozicion përdoruesve të synuar. Informacioni për çështjen në fjalë ju jepet përdoruesve të synuar nëpërmjet raportit të dhënies së sigurisë.

29.1.8 Pavarësia kërkon që eksperti kontabël i regjistruar të karakterizohet nga:

Pavarësia e të menduarit – d.m.th. gjendja e të menduarit, e cila lejon shprehjen e një konkluzioni pa u ndikuar nga influencat që kompromentojnë gjykimin profesional. Kjo gjendje bën që një individ të veprojë me integritet dhe të ushtrojë objektivitetin dhe skepticizmin profesional.

Pavarësia në dukje (në aparence) – d.m.th. mënjanimi i atyre fakteve dhe rrethanave që janë kaq të rëndësishme, sa që një palë e tretë e arsyeshme dhe e informuar, e cila ka njohuri për të gjitha informacionet përkatëse, përfshirë edhe masat mbrojtëse që zbatohen do të arrinte, në mënyrë të arsyeshme, në përfundimin se kompromentojnë integritetin e një firme apo të një anëtari të grupit të dhënies së sigurisë.

29.1.9 Me pavarësinë mund të lidhen shumë rrethana të ndryshme apo kombinime të tyre, për pasojë është e pamundur që të përkufizohet çdo situatë që krijon kërcënime ndaj saj dhe të specifikohen veprimet përmirësuese të duhura që duhet të kryhen. Veç kësaj, për shkak të mundësisë së ndryshimit të natyrës së angazhimeve të dhënies së sigurisë mund të dalin në pah kërcënime të ndryshme, që do të kërkonin zbatimin e masave të tjera mbrojtëse. Për këtë arsye, në ndryshim nga respektimi i një serie rregullash specifike që mund të ndodhë të jenë edhe arbitrare, publikut i intereson zbatimi i një kuadri konceptual që kërkon nga ekspertët kontabël të regjistruar, firmat dhe anëtarët e grupeve të dhënies së sigurisë, të identifikojnë, vlerësojnë dhe trajtojnë kërcënimet që i bëhen pavarësisë.

## **29.2 Zbatimi i Metodës Konceptuale për Pavarësinë**

29.2.1. Ekspertët kontabël të regjistruar, anëtarët e grupeve të dhënies së sigurisë, firmat dhe firmat rrjet, sipas rrethanave të veçanta me të cilat ato ndeshen, duhet të zbatojnë kuadrin konceptual që jepet në pagrafët 10.2 (10.2.1-10.1.6) të pjesës A të këtij Kodi. Veç kësaj, për të identifikuar marrëdhëniet midis firmës, firmave rrjet, anëtarëve të grupeve të dhënies së sigurisë dhe klientëve të sigurisë, duhet të vlerësohet gjithashtu, edhe fakti nëse marrëdhëniet midis individëve jashtë grupit të dhënies së sigurisë dhe klientit të sigurisë krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë. Kuadri kërkon që anëtarët e grupeve të dhënies së sigurisë, firmave dhe firmave rrjet të identifikojnë kërcënimet që i bëhen pavarësisë, të vlerësojnë rëndësinë e këtyre kërcënimeve, dhe nëse ato nuk janë krejt të parëndësishme, të identifikojnë dhe zbatojnë masat e duhura mbrojtëse për të eliminuar kërcënimet apo për t'i zvogëluar ato në një nivel të

pranueshëm. Për të përcaktuar se cilat masa mbrojtëse duhen zbatuar eksperti kontabël i regjistruar duhet të përdorë gjykimin profesional. Disa masa mbrojtëse mund të eliminojnë kërcënimin, ndërsa disa të tjera mund ta zvogëlojnë atë në një nivel të pranueshëm. Për këtë arsye, ekspertët kontabël të regjistruar, anëtarët e grupeve të dhënies së sigurisë, firmat dhe firmat rrjet duhet që kuadrin ta zbatojnë sipas rrethanave specifike. Përveç identifikimit të marrëdhënieve midis firmës, firmave rrjet, anëtarëve të grupit të dhënies së sigurisë dhe klientit të cilit i jepet shërbimi i sigurisë, vlerësime duhet të bëhen edhe përsa i takon marrëdhënieve midis individëve jashtë grupit dhe klientit, të cilat paraqesin kërcënim ndaj pavarësisë.

29.2.2 Shembujt e paraqitur në këtë pjesë të Kodit synojnë të ilustrojnë zbatimin e kuadrit dhe nuk parashikohet të jenë, dhe as nuk duhet të interpretohen si një listë që përfshin të gjitha rrethanat që mund të krijojnë kërcënime ndaj pavarësisë. Për pasojë, për një anëtar të një grupi të dhënies së sigurisë, një firmë apo firmat rrjet, nuk mjafton që, thjesht të veprojnë në pajtim me shembujt e paraqitur, por për më tepër, ato duhet të zbatojnë kuadrin sipas rrethanave specifike me të cilat ndeshen.

29.2.3 Natyra e kërcënimeve që i bëhen pavarësisë dhe zbatimi i masave të nevojshme mbrojtëse që eliminojnë kërcënimet apo i zvogëlojnë ato në një nivel të pranueshëm, ndryshon në varësi të karakteristikave të angazhimeve individuale të dhënies së sigurisë; në se është një angazhim për auditimin e pasqyrave financiare ose një lloj tjetër angazhimi për dhënien e sigurisë; dhe në analizë të fundit, nga qëllimi, informacioni për çështjen në fjalë dhe përdoruesit e synuar të raportit. Prandaj, kur një firmë merr vendim në se është e përshtatëshme ose jo të pranohet të vazhdohet një angazhim, ajo duhet të vlerësojë rrethanat përkatëse, natyrën e angazhimit të dhënies së sigurisë dhe kërcënimet ndaj pavarësisë, natyrën e masave mbrojtëse që kërkohen dhe faktin nëse një individ i veçantë duhet të jetë ose jo anëtar i grupit të dhënies së sigurisë.

### **29.3 Angazhimet e Sigurisë që Bazohen në Pohime**

#### **Angazhimet për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

29.3.1 Meqënëse angazhimet për auditimin e pasqyrave financiare kryhen për një rang të gjërë të përdoruesve potencialë, përveç pavarësisë në mendim, një rëndësi të veçantë mer edhe pavarësia në dukje. Kjo është arsyeja që, anëtarët e grupit të dhënies së sigurisë, firmat dhe firmat rrjet kërkohet të jenë të pavarura nga klientët të cilëve ato ju auditojnë pasqyrat financiare. Këto kërkesa për pavarësinë përfshijnë ndalimin e disa marrëdhënieve midis anëtarëve të grupit të dhënies së sigurisë dhe drejtorëve, zyrtarëve e punëmarrësve të klientit, që janë në pozicione ku ushtrojnë influencë të madhe e direkte mbi informacionet që kanë të bëjnë me çështjen në fjalë (pasqyrat financiare). Gjithashtu, duhet të mbahet parasysh edhe fakti nëse kërcënimet ndaj pavarësisë janë krijuar nga marrëdhëniet me punëmarrësit e klientit, që

kanë pozicione ku ushtrohet influencë të madhe e direkte mbi çështjen në fjalë (gjendja financiare, performanca financiare dhe rrjedhjet e parasë).

29.3.2 Për të garantuar pavarësinë një ekspert kontabël i regjistruar, person fizik ose firmë nuk mund të kryejë një shërbim të auditimit të pasqyrave financiare për një klient, po qe se në lidhje me këtë klient ai ndodhet në një nga pozitat e mëposhtëme:

- (a) Është themelues, kontribues në natyrë, ose person tjetër që përfiton avantazhe të veçanta nga shoqëria tregtare ose filialet e saj.
- (b) Midis ekspertit kontabël të regjistruar dhe themeluesve, anëtarëve të drejtorisë ose të këshillit mbikëqyrës të shoqërisë tregtare e filialeve të saj, ekzistojnë lidhje të cilat shkojnë deri në shkallën e katërt të farefisnisë dhe të krushqisë, duke përfshirë edhe këtë shkallë.
- (c) Eksperti kontabël i regjistruar ose bashkëshorti i tij/saj përfiton nga themeluesit, anëtarët e drejtorise ose të këshillit mbikëqyrës ose nga shoqëria një pagë apo shpërblim çfarëdo për veprimtari që nuk lidhet me kryerjen e shërbimeve të lejuara të dhënies së sigurisë (auditimit).
- (d) Në rastin e një firme auditimi kur një anëtar ortak, aksioner apo drejtues i firmës së auditimit ndodhet në njërin nga pozitat e përshkruara në pikat e mësipërme (a,b,c)

29.3.3 Personat që kanë qënë anëtarë të drejtorisë, administratorë ose të punësuar të një shoqërie, nuk mund të emërohen ekspertë kontabël të regjistruar të kësaj shoqërie, të paktën për një periudhë prej pesë vjetësh duke filluar që nga koha e ndërprerjes së funksioneve të tyre.

#### **Angazhime të Tjera të Dhënies së Sigurisë që Bazohen në Pohime**

29.3.4 Në një angazhim të dhënies së sigurisë, ku klientit nuk i jepet shërbimi i auditimit të pasqyrave financiare, anëtarët e grupit të angazhuar për dhënien e sigurisë dhe firma kërkohet që të jenë të pavarur nga klienti që merr shërbimin e sigurisë. Këto kërkesa të pavarësisë përfshijnë ndalimin e disa marrëdhënieve midis anëtarëve të grupit të dhënies së sigurisë dhe drejtorëve, zyrtarëve dhe të punësuarëve të klientit, që janë në pozicione në të cilat ata mund të ushtrojnë influencë të madhe e të drejtëpërdrejtë mbi informacionet që kanë të bëjnë me çështjen në fjalë. Po kështu, duhet të merret në konsideratë edhe fakti në se kërcënimet ndaj pavarësisë krijohen nga marrëdhëniet me të punësuarit e klientit, që janë në pozicione, në të cilat ata mund të ushtrojnë influencë të madhe e të drejtëpërdrejtë mbi informacionet që kanë të bëjnë me çështjen e angazhimit. Gjithashtu, është e nevojshme që të mbahen parasysh edhe ato kërcënime që firma ka arsye të besojë se mund të krijohen nga marrëdhëniet dhe interesat e firmës rrjet.

- 29.3.5 Në shumicën e angazhimeve të dhënies së sigurisë që bazohen në pohime, të cilat nuk janë angazhime të auditimit të pasqyrave financiare, pala përgjegjëse ka përgjegjësinë për informacionet lidhur me çështjen në fjalë dhe për vetë çështjen në fjalë (që shqyrtohet). Megjithatë, në disa angazhime, pala përgjegjëse mund të mos ketë përgjegjësinë për çështjen që shqyrtohet. Për shëmbull, në rastin kur një ekspert kontabël i regjistruar merr përsipër kryerjen e një angazhimi për dhënien e sigurisë për një raport të përgatitur nga një konsulent mjedisi, lidhur me ndikimin që kanë në mjedis të praktikave që përdor një shoqëri tregtare, raport i cili duhet t'u jepet perdoruesve të synuar; konsulenti i mjedisit është pala përgjegjëse për informacionet rreth çështjes në fjalë, ndërsa shoqëria tregtare është përgjegjëse për çështjen në fjalë (praktikat që përdor shoqëria tregtare).
- 29.3.6 Në këto angazhime sigurie që bazohen në pohime, të cilat nuk janë angazhime të auditimit të pasqyrave financiare, ku pala përgjegjëse ka përgjegjësinë për informacionet lidhur me çështjen që shqyrtohet, dhe jo për vetë çështjen që shqyrtohet, anëtarët e grupit të dhënies së sigurisë dhe firma duhet të jenë të pavarur nga pala që përgjigjet për informacionet që lidhen me çështjen që shqyrtohet (klienti i sigurisë). Veç kësaj, duhet të vlerësohet edhe çdo kërcënim tjetër, për të cilin firma ka arsye të besojë se mund të krijohet nga interesat dhe marrëdhëniet që ekzistojnë midis një anëtari të grupit të dhënies së sigurisë, firmës, firmës rrjet dhe palës që është përgjegjëse për çështjen që shqyrtohet.

#### **29.4 Angazhimet e Dhënies së Sigurisë që Raportohen Drejtëpërdrejt**

- 29.4.1 Në një angazhim për dhënien e sigurisë që raportohet drejtëpërdrejt, anëtarët e grupit të dhënies së sigurisë dhe firma kërkohet të jenë të pavarur nga klienti i sigurisë (pala që është përgjegjëse për çështjen në fjalë).

#### **29.5 Raportet me Përdorime të Kufizuara**

- 29.5.1 Në rastin e një raporti të dhënies së sigurisë, që ka të bëjë me një klient të cilit nuk i auditohen pasqyrat financiare, raport i cili shprehimisht është i kufizuar për t'u përdorur vetëm nga disa përdorues të identifikuar, përdoruesit e raportit konsiderohen se kanë marrë dijeni përse i takon qëllimit, informacioneve për çështjen që shqyrtohet dhe kufizimeve të raportit, përmes pjesëmarrjes së tyre në përcaktimin e natyrës, objektit dhe të instruksioneve për firmën lidhur me dhënien e shërbimeve, përfshirë edhe kriteret kundrejt të cilave duhet të vlerësohet apo matet çështja që shqyrtohet. Kjo dijeni, dhe aftësia e firmës për të komunikuar masat mbrojtëse me të gjithë përdoruesit e raportit, shton efektivitetin e këtyre masave përse i përket pavarësisë në dukje. Këto rrethana mund të mbahen parasysh nga firma kur ajo vlerëson kërcënimet që i bëhen pavarësisë dhe kur ajo vlerëson masat mbrojtëse të nevojshme që duhen zbatuar për të eliminuar apo zvogëluar kërcënimet në një nivel të pranueshëm. Për të vlerësuar pavarësinë e anëtarëve të grupit të dhënies së sigurisë dhe të

afermve të tyre të drejtëpërdrejtë e të ngushtë familjes, minimalisht do të mjaftonte zbatimi i dispozitave të këtij paragrafi. Për më tepër, në qoftë se firma ka, tek klienti që i jepet shërbimi i sigurisë, një interes material të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë, kërcënimi që buron nga egoizmi do të ishte kaq i konsiderueshëm sa që asnjë masë mbrojtëse nuk do të ishte në gjendje ta zvogëlonte atë (kërcënimin) në një nivel të ulët të pranueshëm.

## **29.6. Ekzistenca e Disa Palëve Përgjegjëse**

29.6.1 Në disa angazhime të dhënies së sigurisë, qofshin këto të bazuara në pohime apo në raportim të drejtëpërdrejtë, të cilat nuk janë angazhime të auditimit të pasqyrave financiare, mund të ketë disa palë përgjegjëse. Për të përcaktuar se për cilën palë duhet të zbatohen ose jo këto dispozita në këto angazhime, firma mund të mbajë parasysh faktin nëse një interes ose marrëdhënie midis firmës, apo një anëtar i grupit të dhënies së sigurisë, dhe një palë përgjegjëse mund të krijonte një kërcënim kundrejt pavarësisë që, në kontekstin e informacioneve për çështjen në shqyrtim, nuk do të ishte krejt i parëndësishëm. Për këtë duhet të mbahen parasysh faktorë të tillë si:

- Materialiteti i informacioneve për çështjen që shqyrtohet (ose materialiteti i çështjes që shqyrtohet) për të cilat ka përgjegjësinë një palë e veçantë;
- Niveli i interesit publik që paraqet angazhimi.

Në qoftë se firma do të arrijë në përfundimin se kërcënimet që i bëjnë pavarësisë, këto marrëdhënie ose interesa me një palë përgjegjëse të caktuar, do të ishin krejt të parëndësishme, atëhere mund të mos ketë nevojë që të zbatohen të gjitha dispozitat e këtij seksioni për atë palë përgjegjëse.

## **29.7 Konsiderata të Tjera**

29.7.1 10Kërcënimet dhe masat mbrojtëse që tregohen në këtë pjesë të Kodit, përgjithësisht janë trajtuar në kontekstin e interesave apo të marrëdhëneive midis firmës, firmave rrjet, anëtarëve të grupit të dhënies së sigurisë, dhe klientit që i jepet siguria. Në rastin e një klienti që i auditohen pasqyrat financiare, i cili është një shoqëri tregtare e listuar në bursë, firma dhe firmat rrjet duhet të marrin parasysh interesat dhe marrëdhëniet me entitetet e lidhura të klientit. Në mënyrë ideale këto entitete dhe interesa a marrëdhënie do të duhet të ishin identifikuar që më parë. Për të gjithë klientët e tjerë që ju jepet siguria, kur grupi i dhënies së sigurisë ka arsye të besojë se një entitet i lidhur i klientit ndikon në pavarësinë e firmës, ai duhet ta mbajë parasysh këtë fakt kur vlerëson pavarësinë dhe zbaton masat e duhura mbrojtëse.

29.7.2 Vlerësimi i kërcënimeve që i bëhen pavarësisë dhe veprimet e mëtejshme duhet të jenë të mbështetura me evidencë e cila merret përpara pranimit të angazhimit dhe gjatë kohës kur kryhet angazhimi. Detyrimi për të bërë këtë



vlerësim dhe për të ndërmarrë veprime lind kur një firmë, një firmë rrjet, ose një anëtar i grupit të dhënies së sigurisë ka dijeni, ose mund të parashikohet në mënyrë të arsyeshme se ka dijeni, për rrethanat dhe marrëdhëniet që mund të kompromentojnë pavarësinë. Mund të ketë raste kur firma, firma rrjet, ose një individ, i shkel këto kërkesa në mënyrë të paqëllimshme. Përgjithësisht, shkeljet e paqëllimshme nuk e kompromentojnë pavarësinë e firmës ndaj një klienti që i jepet siguria, në qoftë se firma ka vendosur në funksionim procedura dhe politika të duhura të kontrollit të cilësisë, të cilat nxisin pavarësinë, korigjimin e shkeljeve menjëherë pasi ato zbulohen, dhe në se zbatohen masat e nevojshme mbrojtëse.

29.7.3 Në të gjithë këtë pjesë të Kodit, kur vlerësohet pavarësia referimi bëhet ndaj kërcënimeve të rëndësishme dhe krejt të parëndësishme. Kur shqyrtohet rëndësia e një çështje të veçantë, duhet të mbahen parasysh si faktorët cilësorë ashtu edhe ata sasiorë. Një çështje mund të konsiderohet si krejt e parëndësishme vetëm në qoftë se ajo gjykohet se është e vogël dhe që ndodh rrallë (nuk përsëritet).

## **29.8 Periudha e Angazhimit**

29.8.1 Anëtarët e grupit të dhënies së sigurisë dhe firma, gjatë gjithë periudhës së angazhimit, duhet të jenë të pavarur nga klienti të cilit i jepet shërbimi i sigurisë. Periudha e angazhimit fillon kur grupi i dhënies së sigurisë nis të kryejë shërbimet e sigurisë dhe mbaron kur lëshohet raporti, përveç rasteve kur angazhimi i dhënies së sigurisë është i një natyre që përsëritet. Në rastet e angazhimeve të dhënies së sigurisë që parashikohet të përsëriten, periudha e angazhimit të dhënies së sigurisë mbaron kur secila nga palët njofton se marrëdhënia profesionale ka përfunduar, ose me dhënien e raportit përfundimtar të sigurisë, cilado që të ndodhë më vonë.

29.8.2 Në rastin e një angazhimi për auditimin e pasqyrave financiare, periudha e angazhimit përfshin periudhën që mbulojnë pasqyrat financiare për të cilat firma e auditimit raporton. Kur një entitet bëhet një klient të cilit i auditohen pasqyrat financiare gjatë, ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare për të cilat firma do të duhet të raportojë, kjo e fundit (firma) duhet të mbajë parasysh faktin në se mund të krijohen kërcënime ndaj pavarësisë nga:

- Marrëdhëniet financiare apo të biznesit me klientin që i jepet shërbimi i auditimit gjatë, ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, por përpara se të pranohet angazhimi për auditimin e pasqyrave financiare; ose
- Shërbimet e mëparëshme që i janë dhënë klientit të auditimit.

Në mënyrë të ngjashme, në rastin e një angazhimi të dhënies së sigurisë, firma duhet të mbajë parasysh faktin nëse ndonjë marrëdhënie financiare apo e

biznesit, ose ndonjë shërbim i mëparshëm, mund të krijojë kërcënime ndaj pavarësisë.

29.8.3 Në qoftë se një klienti, të cilit i auditohen pasqyrat financiare, gjatë ose pas periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare, por përpara se të fillonin shërbimet profesionale që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare, i është dhënë një shërbim i jo-sigurisë (që nuk ka të bëjë me dhënien e sigurisë), dhe ky shërbim ndalohet të jepet gjatë periudhës së angazhimit të auditimit, atëhere duhet të mbahen parasysh kërcënimet ndaj pavarësisë, po qe se ka të tilla, të cilat lindin nga ky shërbim. Në qoftë se kërcënimi nuk është krejt i parëndësishëm, atëhere duhet të merren parasysh e të zbatohen masat e nevojshme mbrojtëse për të zvogëluar kërcënimin në një nivel të pranueshëm. Në këto masa mund të përfshihen:

- Diskutimi i çështjeve të pavarësisë që i përkasin dhënies së shërbimeve, të cilat janë të ndryshme nga shërbimet e sigurisë, me personat që janë ngarkuar me qeverisjen e klientit, siç është komiteti i auditimit;
- Marrja e sigurisë që klienti e pranon përgjegjësinë në lidhje me pasojat që rrjedhin nga kryerja prej firmës e shërbimit të jo-sigurisë;
- Moslejimi i personelit, që ka dhënë një shërbim të jo-sigurisë, për të marrë pjesë edhe në angazhimin e auditimit të pasqyrave financiare; dhe
- Angazhimi i një firme tjetër për të rishikuar rezultatet e shërbimit të jo-sigurisë ose angazhimi i një firme tjetër që të rikryejë këtë shërbim deri në atë shkallë që i jep mundësi asaj të marrë përgjegjësinë për shërbimin.

29.8.4 Një shërbim jo-sigurie që i jepet një klienti të palistuar, të cilit i auditohen pasqyrat financiare, nuk e dëmton pavarësinë e firmës në rastin kur klienti bëhet një entitet i listuar në qoftë se:

- (a) Shërbimi i mëparshëm i jo-sigurisë ka qënë i lejuar për klientët e palistuar të cilëve ju auditohen pasqyrat financiare;
- (b) Shërbimi përfundohet brenda një periudhe kohe të arsyeshme, nga koha kur klienti bëhet entitet i listuar, po qe se këto shërbime janë të ndaluara për klientët e auditimit që janë entitete të listuara; dhe
- (c) Firma ka zbatuar masat e duhura mbrojtëse për të eliminuar kërcënimet ndaj pavarësisë që vijnë nga shërbimi i mëparshëm, ose i ka zvogëluar ato në një nivel të pranueshëm.

## **30 Hyrja në fuqi**

### **30.1 Ky Kod i Etikës është i zbatueshëm duke filluar nga data 1 Janar 2007**